Rruga Arbërit

GAZETË E PAVARUR. NR. (9)29. SHTATOR 2008. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO

"Risku" sh.p.k.
Market "Ken"
Laprakë, Tiranë
Tel: +355 4 22 50 480
Cel. 068 20 36 394

HISTORI

Kryengritja e shtatorit dhe masakrat serbe të tetorit 1913 në Dibër

NGA: **MOISI MURRA - FAQE 12**

BOTIME

"Rrëfimet në hije", si skulpturat e Mikelanxhelos

NGA: **GJEKE MARINAJ - FAQE 8**

PROFIL

Toni Dovolani: Jam krenar që po e tregoj veten se jam shqiptar!

NGA: **BEQIR SINA - FAQE 13**

DEBAT

Mendime për Universitetin Dibran të Mendimit

Nga AFRIM KAROSHI

Ideja për ngritjen e një universite ti në Dibër ishte e papritur dhe intriguese. Në pak rrjeshta, është shtjelluar me detaje programi, prespektiva, domosdoshmëria dhe përparësitë që ofron Dibra për një institucion arsimor të këtyre përmasave.

Gjithashtu, parashtrimi i kësaj ideje është i guximshëm dhe kurajoz, në sfondin e realitetit të vështirë dhe të nxituar shqiptar, në të cilin universitetet lindin e vdesin brenda ditës. Fatkeqësia nuk është mungesa e ideve, por madje edhe paaftësia për të kopjuar modele të suksesshme perëndimore në fushën e edukimit.

Ngaqë kam pasur një përvojë në një institucion akademik perëndimor, po guxoj edhe unë të shtjelloj ca aspekte të rëndësishme për t'u marrë parasysh, me shpresën që ky Universitet, jo vetëm të bëhet realitet, por të kthehet në model për institucionet tashmë egzistuese në Shqipëri dhe në rajon.

***E para*, universitetet nuk janë "për matrapazë e qelepirxhinj", madje as kur këta të fundit janë të fushës akademike. Freskia që ofron ideja e parashtruar, nuk shkon me interesa të ngushta të njerëzve dritëshkurtër. Ideja, kërkon jo vetëm strategji praktike por edhe njerëz "strategjik". Njerëz strategjik, janë ata që e duan arsimin, që e duan edukimin e njerëzve, që kanë një standard të lartë për njeriun dhe për jetën. Për çfarë do të na shërbejë universiteti? Pavarësisht, nga nevoja reale dhe praktike për të siguruar tregun e nevojshëm të punës, universitetet që në origjinën e tyre, janë krijuar për të sistemuar njohuritë tona për realitetin, për ti dhënë kuptim jetës dhe marrëdhënieve të gjithanshme njerëzore.** *(Lexoni në faqe 2)*

EKSKLUZIVE / INTERVISTË ME PREFEKTIN E QARKUT DIBËR, Z. XHAFER SEITI: ME PUNË ARRIHET GJITHÇKA

Ja investimet në Dibër

Vazhdimi i punimeve në Rrugën e Arbrit dhe vënia e Parkut Kombëtar të Lurës nën mbrojtjen e UNESCO-s, dy nga prioritetet e punës si Prefekt i Dibrës

FAQE 4,5

KRYEMINISTRI BERISHA NË MAT:

Së shpejti do të fillojë ndërtimi i Rrugës së Arbrit në trajektoren e saj të plotë

FAQE 5

Nga punimet në Rrugën e Arbërit. Foto. H. Uka

Veçojmë nga Plani Strategjik i Ministrisë së Transporteve për vitet 2008-2013:

1. **Përfundimi Bulqizë - Bllatë - U.Çerenecit 1.2 miliard lekë në vitin 2009.**
2. **U.Çerenecit - Peshkopi 2.7 miliard lekë në vitin 2011.**
3. **Bulqizë-Tiranë rreth 13 miliardë lekë në vitin 2013.**

Kryeministri Berisha në Mat:

"Një seri rrugësh, janë në projekt për asfaltim, ndër të cilat rruga që ju shkurton lidhjen me Tiranën, Rruga e Arbrit që është edhe projekti më madhor. Ajo po ecën. Së shpejti do të fillojë ndërtimi i Rrugës së Arbrit në trajektoren e saj të plotë.

Redaksia uron gjithë besimtarët:

GËZUAR FESTËN E BAJRAMIT!

"1 USD FOR DIBRA"

Shpresë për zhvillim më të shpejtë

Nga: **REXHEP TORTE** - Faqe 3

EMIGRACION

Amerika është për amerikanët

ABDURAHIM ASHIKU- Faqe 10

ARSIM

Shkollat e para shqipe në Dibër

NGA: **XHEMAL DOMI**- Faqe 11

PERVJETOR

Pedagogjikja

NGA: **XHAFER MARTINI**- Faqe 11

AKTUALITET

Nikolas Knauf shpallet "Qytetar Nderi" i Dibrës

NGA: **R. TORTE** - Faqe 7

Ideja për ngritjen e një Universiteti në Dibër ishte e papritur dhe intriguese. **Ky Universitet** *jo vetëm të bëhet realitet, por* **të kthehet në model për institucionet ekzistuese në Shqipëri** *dhe në rajon*

Mendime për **Universitetin** Dibran të **Mendimit**

Nga **AFRIM KAROSHI**

Ideja për ngritjen e një universiteti në Dibër ishte e papritur dhe intriguese. Në pak rrjeshta, është shtjelluar me detaje programi, prespektiva, domosdoshmëria dhe përparësitë që ofron Dibra për një institucion arsimor të këtyre përmasave.

Gjithashtu, parashtrimi i kësaj ideje është i guximshëm dhe kurajoz, në sfondin e realitetit të vështirë dhe të nxituar shqiptar, në të cilin universitetet lindin e vdesin brenda ditës. Fatkeqësia nuk është mungesa e ideve, por madje edhe paaftësia për të kopjuar modele të suksesshme perëndimore në fushën e edukimit.

Ngaqë kam pasur një përvojë në një institucion akademik perëndimor, po guxoj edhe unë të shtjelloj ca aspekte të rëndësishme për t'u marrë parasysh, me shpresën që ky Universitet, jo vetëm të bëhet realitet, por të kthehet në model për institucionet tashmë egzistuese në Shqipëri dhe në rajon.

E para, universitetet nuk janë "për matrapazë e qelepirxhinj", madje as kur këta të fundit janë të fushës akademike. Freskia që ofron ideja e parashtruar, nuk shkon me interesa të ngushta të njerëzve dritëshkurtër. Ideja, kërkon jo vetëm strategji praktike por edhe njerëz "strategjik". Njerëz strategjik, janë ata që e duan arsimin, që e duan edukimin e njerëzve, që kanë një standard të lartë për njeriun dhe për jetën. Për çfarë do të na shërbejë universiteti? Pavarësisht, nga nevoja reale dhe praktike për të siguruar tregun e nevojshëm të punës, universitetet që në origjinën e tyre, janë krijuar për të sistemuar njohuritë tona për realitetin, për ti dhënë kuptim jetës dhe marrëdhënieve të gjithanshme njerëzore. Unë e shikoj këtë aspekt si mungesën më të madhe serioze që e cënon ngritjen e një institucion akademik serioz, ashtu siç pengon transformimin e universiteteve ekzistuese. Prej vitesh tashmë, kam pasur rastin të vëzhgoj nga afër drejtues universitetesh shqiptare në nivele të ndryshme. Qartazi dallohet për shumicën e tyre që konceptet bazë për edukimin mungojnë. A është edukimi shkëmbim informacioni? A bëhet edukimi nëse profesorët paguhen më mirë? Po nëse ndryshohen emrat e universiteteve, a do të prodhohen si rezultat profesionistë të aftë? Konteksti perëndimor i edukimit që duam të përshtasim, i ka tejkaluar disa prej këtyre pyetjeve. Ne nuk kemi nevojë të kalojmë kohë me një eksperiment të dështuar. A i kemi këta lloj njerëzish? Dhëntë Zoti po, se ndryshe jo vetëm që Universiteti i Mendimit në Dibër nuk ngrihet dot, por gjithë struktura e shoqërisë sonë është e rrezikuar seriozisht në lakun e interesaxhinjve dhe grykësisë për përfitime cektësisht personale.

E dyta, ngritja e një institucioni të këtij lloji, kërkon investitorë që janë dashamirës të edukimit më shumë sesa të përfitimeve të tyre personale. Ngritja e një sistemi ligjor, krijimi i lehtësirave për biznese që investojnë në arsim jo vetëm është domosdoshmëri, por tashmë është urgjente. Në mungesë të këtyre lehtësirave, gjithmonë ata që investojnë, do të presin "të nxjerrin çfarë mund të nxjerrin" nga kjo punë, patjetër duke cënuar seriozitetin dhe standardin akademik të universitetit.

E treta, universiteti i Dibrës kërkon jo vetëm një program të detajuar, të ndërtuar me kujdes dhe të gjithanshëm në bazë të fokusit që do të ketë, por gjithashtu kërkon një perspektivë kërkimore-shkencore që të mbështesë këtë program. Me fjalë të tjera, të ndërtosh universitetin mund të kërkojë kohë, por të bësh kërkime në fusha të ndryshme si mendimologji, sisteme mendimi, shkencë, fe, histori nuk duhet të presësh ngritjen e institucionit. Ndoshta kam informacionin e mangët, por është problem i madh për edukimin shqiptar, mungesa e proceseve të zhvilluara akademiko-kërkimore, që prodhojnë dije të sistemuara, të cilat mund të përdoren në tekste shkollore. Gjatë viteve që isha vetë student në Universitetin e Tiranës, shumica e teksteve të kërkuara në kurse, ishin thjesht përshtatje, përkthime ose vepra të copëzuara të fushës, që kryesisht mbulojnë nevojat financiare të disa prej profesorëve, por nuk plotësojnë nevojat e studentit për dije të plota në atë aspekt akademik. Domosdoshmëria e kërkimeve serioze dhe përshtatja e rezultateve të këtyre kërkimeve me nevojat e personit që do të formohet është urgjente.

Siç mund të dallohet, kam lënë mënjanë trajtime specifike për lëndët, fokusin e universitetit dhe domosdoshmërinë e ngritjes së tij. Specialistë të fushave përkatëse do të flasin (dhe shpresoj të flasin!) ku e ku më bukur se unë.

Vetëm mendova që zëri i specialistëve duhet paraprirë ose duhet shtjelluar në të njëjtën kohë me ca pyetje të rëndësishme në lidhje me strukturën e nevojshme për edukim, njerëzit e përshtatshëm për ta çuar përpara këtë proces dhe në fund të fundit, me këndvështrimin e duhur për gjithë edukimin në tërësi.

Dikush duhet ta fillojë këtë proces, jo vetëm në interes të ngritjes së një universiteti të ri, por edhe në interes të transformimit rrënjësor, aq të nevojshëm për gjithë strukturën akademike dhe sociale të shoqërisë sonë.

Dhe Dibrës i shkon shumë mirë kjo punë...

Universiteti i Dallasit

Ideja kërkon jo vetëm strategji praktike, por edhe njerëz "strategjik". Njerëz strategjik janë ata që e duan arsimin, që e duan edukimin e njerëzve, që kanë një standard të lartë për njeriun dhe për jetën.

Për çfarë do të na shërbejë universiteti? Pavarësisht nga nevoja reale dhe praktike për të siguruar tregun e nevojshëm të punës, universitetet që në origjinën e tyre janë krijuar për të sistemuar njohuritë tona për realitetin, për t'i dhënë kuptim jetës dhe marrëdhënieve të gjithanshme njerëzore.

Ngritja e një institucioni të këtij lloji, kërkon investitorë, që janë dashamirës të edukimit më shumë sesa të përfitimeve të tyre personale.

DIBËR E MADHE / Përshëndetet liberalizimi i vizave

Fida dhe Krosi: Mundësi për zhvillim të gjithanshëm

Argëtim Fida, kryetar i Komunës së Dibës së Madhe dhe Ilir Krosi, kryetar i Bashkisë së Peshkopisë, u takuan më 5 shtator në Dibër të Madhe për të përshëndetur aktin e liberalizimit të vizave mes Shqipërisë e Maqedonisë. Me këtë rast ata para mediave dhanë prononcimet e tyre.

Argëtim Fida, theksoi se "Me kënaqësi të madhe prita Ilir Krosin, kryetarin e Bashkisë së Peshkopisë, që bashkarisht ta festojmë këtë sukses të arritur pas disa vitesh angazhimi të përbashkët të qeveritë tona respektive, për t'i bindur dy shtetet tona që më fund të bëhet liberalizimi i vizave për banorët në dy anët e kufirit. Angazhimet tona nuk do të përfundojnë këtu.Unë jam i shqetësuar lidhur me sigurimet që aplikohen pas këtij liberalizimi, do të verifikoj a është e obligueshme kjo edhe për shtetasit e Serbisë, Malit të Zi, Kosovës dhe shteteve tjera gjatë hyrjes së tyre në Maqedoni.

Në vendkalimin kufitar të Bllatës me një marrëveshje ndërshtetërore para disa viteve është ndaluar qarkullimi i mallrave të akcizës. Sot kur tentojmë të rritet frekuenca e kësaj pike kufitare do të angazhohemi të dy qeveritë tona, që pika kufitare e Bllatës të marrë rolin e një pike ku do të mund të kalojnë tërë mallrat. Kjo lidhet edhe me angazhimin e dy Dibrave për përfundimin e Rrugs së Arbërit, ku pika kufitare mes dy Dibrave do të jetë arterie kryesore në shkëmbimin e mallrave mes dy shteteve dhe në rajon. Përshëndesim fuqishëm këtë sukses të madh që mes dy Dibrave të rritet zhvillimi kulturor dhe ekonomik.

Dibra e Madhe historikisht ka qenë e lidhur me shumë fshatra të Shqipërisë. Këto fshatra e kanë shumë më afër Dibrën e Madhe se sa Peshkopinë, ndaj duhet hapur vendkalimin kufitar te Mireshi, ku ekziston infrastruktura rrugore.

Me liberalizimin e vizave dhe përfundimin e Rrugës së Arbërit, Dibra e Madhe do të jetë hallka që do ta

Posta e Rruga Arbërit

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Redaksia u kujton bashkëpunëtorëve të saj, zotërinjve Agron Tufa, Ramiz Gjini, Selman Mziu, Xhelal Roçi, Kujtim Boriçi, Beqir Sina, Moisi Murra etj., se shkrimet e tyre, për arsye vendi nuk janë botuar në këtë numër.
Ato do të botohen në numrat e ardhshëm të gazetës "Rruga e Arbërit".

Gjithashtu, ju kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!



DREJTOR:
Rakip Suli

Këshilli Botues:
Musa Riçku
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Redaksia:
Në Dibër:
Rexhep Torte
Në Athinë:
Abdurrahim Ashiku
Në Itali:
Selman Mziu
Në New York:
Beqir Sina
Në Tiranë:
Prof. Dr. Bashkim Lleshi,
Naim Plaku

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. (04) 2233 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

U THEMELUA SHOQATA "1 DOLLAR PËR DIBRËN"

Shpresë për zhvillim më të shpejtë

Nga **Rexhep TORTE**

Në Dibër të Madhe u themelua Shoqata "1 Dollar për Dibrën". Anëtarët dhe aktivistët e kësaj shoqate realizimin e aktiviteteve dhe të projekteve do ta kryejnë në mënyrë vullnetare dhe pa pagesë. Kjo shoqatë do të jetë e hapur për të gjithë që dëshirojnë të kontribuojnë dhe transparente në punën e saj.

Valbona Dovolani, duke e hapur këtë takim, tha se: "Kjo shoqatë do ta përfaqësojë zërin e qytetarëve dhe do të ndërmarrë nisma për zgjidhjen e problemeve për një të ardhme më të mirë të qytetit. Nuk duhet të na dëshpërojë situata e vështirë në të cilën ndodhemi, por duhet të angazhohemi për të dalë nga kjo situatë. Kemi shpresa të mëdha në kontributin që mund ta japë kjo shoqatë në zgjidhjen e problemeve ekonomike, kulturore, fetare, arsimore dhe ekologjike".

Esat Ushtelenca, duke folur për programin e aktiviteteve të kësaj shoqate për këtë vit, shtoi se: "Kjo shoqatë do të organizojë aktivitete vullnetare për pyllëzim dhe mirëmbajtje të hapësirave të gjelbërta, vendosjen e policëve të shtrirë pranë shkollave dhe në vendet e tjera të rrezikshme për kalimtarët, përmirësimin e ndriçimit publik, ngjyrosjen dhe mirëmbajtjen e oborreve të shkollave, çerdheve, këndeve të lojrave dhe poligoneve sportive, krijimin e një vendparkimi të automobilave pranë liqenit të Dibrës, vendosjen e koshave për plehra në qytet, ndërtimin e kampeve turistike rreth lumit Radikë dhe liqenit, peticione për eliminimin e dukurive që e prishin imazhin e qytetit, krijimin e këndeve të lojërave për fëmijë, organizimin e sondazheve me qytetarët për ambient të pastër, nxitjen e institucioneve kompetente për hapjen e disa fakulteteve në Dibër të Madhe, bashkëpunimin me të gjitha OJQ-të për zhvillimin, edukimin dhe ngritjen e vetëdijes qytetare për një shoqëri të shëndoshë, aktivizimin e një kinema verore dhe organizimin e ndihmës financiare për nxënës dhe studentë të talentuar, por që janë në gjendje të vështirë ekonomike".

Kjo shoqatë do ta përfaqësojë zërin e qytetarëve dhe do të ndërmarrë nisma për zgjidhjen e problemeve për një të ardhme më të mirë të qytetit. Nuk duhet të na dëshpërojë situata e vështirë në të cilën ndodhemi, por duhet të angazhohemi për të dalë nga kjo situatë.

Roland Pahumi, shpjegoi mënyrën dhe procedurat bankare për arritjen e këtyre parave nga mërgata dibrane në vendlindje, për mënyrën se si do të mbikëqyret shpenzimi i tyre nëpërmjet këshillit mbikëqyrës dhe web faqes së shoqatës.

Argëtim Fida, kryetar i Komunës së Dibrës së Madhe, duke përshëndetur të pranishmit, u shpreh se: "Pushteti vendor e mbështetën këtë ide, guxim dhe vullnetarizëm të rinjve dibranë nga mërgata, që për çdo anëtar të familjes të paguhet nga 1 dollar ose 1 euro në muaj, si kontribut për qytetin e tyre. Në qytet ekzistojnë edhe shumë OJQ tjera që në programin e aktiviteteve kanë zgjidhjen e shumë problemeve që e mundojnë qytetin. Puna më e madhe duhet bërë në sensibilizimin e mërgatës dhe në grumbullimin e mejteve financiare, dhe më pastaj nëpërmjet forumeve të bashkësive do të bëjmë zgjedhjen e projeteve më me përparësi për qytetin", tha Fida.

Gjatë diskutimit u fol për mënyrën e funsionimit të këtij fondi, ngritjen e vetëdijes qytetare, eliminimin e inateve, përbaltjeve e paragjykimeve, dhe angazhimin për ta nxjerrë Dibrën e Madhe nga kolapsi ekonomik në të cilin ndodhet edhe nëpërmjet tregut të lirë, zonës së lirë doganore, ligjeve të favorshme fiskale dhe krijimin e mundësive dhe lirive ekonomike zhvillimore.

Në foto: Argëtim Fida dhe Ilir Krosi

lidh Shkupin me Tiranën e Durrësin.Kjo do të ndikojë në zhvillimin dhe hapjen e vendeve të reja të punës dhe do të ketë një impakt pozitiv në ekonominë dibrane", tha Fida.

Ilir Krosi, kryetar i Bashkisë së Peshkopisë, u shpreh se: "Për komunitetin e Dibrës në Shqipëri dhe për tërë komunitetin e rajonit kufitar, kjo është një ditë e gëzuar, një ngjarje e madhe pas përpjekjeve të mëdha që janë bërë nga shumë faktorë, pse jo edhe nga ne, që më në fund u përfundua me sukses me arritjen e liberalizimit të vizave. Shprehim mirënjohjen për Qeverinë e Shqipërisë, Maqedonisë dhe të parlamenteve të dy vendeve, që më në fund arritën të marrin në konsideratë këtë shqetësim njerëzor e qytetar të banorëve të dy vendeve, për ta bërë *"de fakto"* liberalizimin e vizave mes dy vendeve dhe heqjen e pengesave kufitare.

Kjo do të ndikojë ndjeshëm për lidhjet e shumta që janë mes dy rajoneve, sepse kemi lidhje gjaku, kulturore dhe ekonomike. Unë mbështes atë që deklaroi homologu im Fida, se kalimi i mallrave të akcizës edhe në doganën e Bllatës do të jetë me shumë rëndësi dhe nga ana jonë do të bëjmë përpjekje pranë qeverisë së Shqipërisë që kjo të realizohet.Tani kur Shqipëria ka bërë hapa të konsiderueshme të njohura ndërkombëtarisht për luftën kundër kontrabandës, evazionit e korrupsionit, janë pjekur të gjitha kushtet që mallrat e akcizës të kalojnë në të gjitha pikat e kalimit, duke mos përjashtuar vendkalimin e Bllatës. Kjo do tu ndihmojë bizneseve të dy vendeve tona për të shtuar fitimet e tyre në këtë treg të zhvilluar.Duhet hapur edhe vendkalime tjera kufitare për të përfshirë edhe fshatrat e Malit të Thatë-Gollobërdos, tha Ilir Krosi.

Rexhep TORTE

Shoqata do punojë në hartimin e detajeve për funsionimin e fondeve të mbledhura, ngritjen e vetëdijes qytetare, eliminimin e inateve, përbaltjeve e paragjykimeve, dhe angazhimin për ta nxjerrë Dibrën e Madhe nga kolapsi ekonomik në të cilin ndodhet edhe nëpërmjet tregut të lirë, zonës së lirë doganore, ligjeve të favorshme fiskale dhe krijimin e mundësive dhe lirive ekonomike zhvillimore.

"1 $ FOR DIBRA", PROTESTA E PARË

Asnjë dibran nuk pranohet në punë në Hidrocentralin e Spiljes

Shqiptarët në Dibër përvec pengesave objektive për punësim, ende hasin në pengesa "arkaiste", ato të kohës së njëmendësisë sllavokomuniste, përkatësisë etnike. Kjo, këto ditë rindodhi në SH.A.Elektranat e Maqedonisë- filiali " Shpilje" –Dibër.

Në punësimin e ditëve të fundit, në këtë organizatë punuese, **në 13 vende të shpallura të lira pune, nuk pranohet asnjë shqiptar.** Të gjithë janë Gligora me "–Ova" ose Evzija me "ski-ja".

Edhe pse përgjigja e këtij veprimi të drejtuesve të H.E." Spilje" pse veprojnë në këtë mënyrë duke mos përfillë shqiptarët në konkurim është e njohur se ata si për herë zbatojnë politikën diferencuese dhe diskriminuese ndaj dibranëve shqiptarë. Por kjo politikë kadrovike diskriminuese ndaj shqiptarëvë në Dibër shtron çështje tjera prej atyre konkrete të drejtëpërdrejta nga veprimi eliminues i shqiptarëve në shpalljen në fjalë e deri te ata politik. A thua në të 13 vendet konkuruese asnjë shqiptar nuk i ka plotësuar kushtet? A thua asnjë shqiptar i paraqitur në Shpilje nuk ka qenë i përshtatshëm për tu punësuar në Shpilje?

Sipas informacioneve që kemi për kuadro të diplomuara që nga shkalla VII gati në të gjitha drejtimet :inxhinjeri, ekonomi, drejtësi, etj. momentalisht ka me dhjetra të diplomuar shqiptarë që paraqiten në Agjensinë për punë në Dibër. Drejtuesit maqedonë të Spiljes edhe pse për vendet e punës në pikat 6 respektivisht 7, kanë konkuruar kandidatë shqiptarë me kualifikim superior-fakultet, nuk janë marë parasysh por janë pranuar të etnive tjera dhe me shkollim të mësëm dhe të ulët.

Paradoksi më madh i këtij institucioni është se në atë 13-shen e të punësuarve thuhet që ka një person me dosje kriminale dhe dy persona që nuk jetojnë në komunen e Dibrës!!

H.E. "Spilje" vazhdon të mbetet bastjon për dibranët shqiptarë dhe atë për të vetmin qëllim që të rinjtë shqiptarë dibranë të vazhdojnë punësimin e tyre jashtë Dibrës, atje prej ku nuk kthehen më,atje prej ku e pakësojnë elementin shqiptar në dibër, atje ku me largimin e tyre realizojnë kërkesat e politikës çubrilloviqe që drejtuesit e H.E."Spilje" e realizojnë në ditët tona.

Shoqata qytetare " 1 $ for dibra" e nxitur nga rasti në fjalë i mospranimit të asnjë shqiptari në shpalljen për punësim i është drejtuar " ELEM" me seli në Shkup dhë përfaqësisë në Dibër " H.E." Spilje" dy herë me shkresa me të dhëna për konkursin, ata nuk na u përgjegjën edhe pse në baze te ligjit për të drejtën e informimit te lire -13/06 (gazeta zyrtare e R.M-së) institucioni i lartpërmendur është i obliguar ti japë këta informacione.

Kërkesat qe ja beri shoqata ndermarjes H.E "Spilje": numri i të punësuarve, kualifikimet, kuadri drejtues, përkatësia /struktura nacionale e të gjithe të punësuarve, mplemetimi i marrëveshjes së Ohrit

Sh.Q. "1 $ for Dibra"

(Marrë nga www.dibra.org))

LETRAT E LEXUESVE

Gazeta "Rruga e Arbërit" është e hapur për të pritur letrat e lexuesve për problemet dhe shqetësimet e tyre.

Redaksia mbetet e hapur për çdo lloj bashkëpunimi, me synimin e vetëm: përhapjen e së vërtetës dhe mendimit progresist.

Redaksia kujton bashkëpunëtorët se doreshkrimet janë të pakthyeshme dhe jo çdo shkrim mund të botohet.

Tel: (04) 2233 283

Cel.068 31 19 232 / 069 20 68 603

E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Rruga Arbërit nr. 29

intervistë

Prefekti i Dibrës, z. Xhafer Seiti, flet ekskluzivisht për gazetën "Rruga e Arbërit" për problemet e zhvillimit të qarkut dhe projektet e realizuara dhe ato në proces, për një integrim sa më të shpejtë të rajonit

INTERVISTË ME PREFEKTIN E QARKUT DIBËR, Z. XHAFER SEITI:
ME PUNË ARRIHET GJITHÇKA

Ja investimet në Dibër

Vazhdimi i punimeve në Rrugën e Arbërit dhe vënia e Parkut Kombëtar të Lurës nën mbrojtjen e UNESCO, dy nga prioritetet e punës si Prefekt i Dibrës

Pyetje: U bënë tre vjet që jeni Prefekt në qarkun e Dibrës. Cilat mendoni se janë disa nga risitë që keni sjellë në qeverisjen rajonale, kur dihet se Prefekti është përfaqësues i Qeverisë në qark?

Përgjigje: Është e saktë që po bëhen gati tre vjet në punën time si Prefekt, pasi jam emëruar me datë 3 tetor 2005.

Që ditën e emërimit kam përcjellë te bashkëpunëtorët angazhimin tim për të qenë në çdo moment shërbëtor i ligjit dhe për t'u bërë garant i zbatimit të pacënuar të tij nga organet e qeverisjes vendore dhe institucionet qëndrore në nivel vendor.

Njëkohësisht kam kërkuar nga administrata angazhim maksimal për të realizuar programin ambicioz të Qeverisë, duke theksuar se matës i punës së secilit do të jetë përkushtimi ndaj saj, profesionalizmi, aftësia për të zgjidhur në kohë e me cilësi detyrat, për t'i shërbyer komunitetit, për të qenë korrekt për zbatimin e detyrave të ngarkuara dhe zbatues po korrekt të të gjitha ligjeve me të cilat punon ky institucion.

Pyetje: Po cilat kanë qenë pikërisht prioritete të punës Suaj?

Përgjigje: Në detyrat që cakton ligji "Për Prefektin" primare për t'u vënë në zbatim kanë qenë:

- Kontrolli i ligjshmërisë së akteve që marrin periodikisht organet e qeverisjes vendore.
- Kontrolli i zbatimit të buxhetit nga organet e qeverisjes vendore.
- Po në zbatim të ligjit të sipërcituar janë bërë të gjitha përpjekjet dhe janë shfrytëzuar të gjitha hapësirat për të nxitur një bashkëpunim efikas ndërmjet vetë organeve të qeverisjes vendore, administratës dhe këshillave vendorë brenda njësisë dhe këtyre të fundit me administratën e institucioneve qëndrore në nivel vendor, natyrisht duke nxitur dhe bashkërendimin institucional të vetë këtyre të fundit.

Për të punuar duhet të njohësh gjendjen, duhet të krijosh besim se me punë e përkushtim mund të arrish gjithçka, ndaj *që në ditët e para të emërimit nisa një inkursion njohës me një tur takimesh në njësitë vendore,* ku bisedova me kryetarët e tyre, të zgjedhurit vendorë në komuna, bashki e fshatra, me banorë të komuniteteve, për të njohur shqetësimet, problematikën, nevojat më emergjente për të investuar në rrugë, shkolla, kopshte, qendra shëndetësore, ambulanca, ujësjellësa, kanalizime, asfaltime etj.

Mbi bazën e kësaj njohjeje, duke shfletuar dhe vendimet e organeve të qeverisjes vendore, duke marrë mendime të intelektualëve të fushave të ndryshme, *kërkova nga administrata* përgatitjen e një plani të mirëstudiuar prioritetesh për investime, i cili pasi u diskutua dhe plotësua në Organin Këshillues të Prefektit, u nis në destinacionet e duhura, në *Digasteret Qeveritare*, për të qenë bazë për planifikimin e investimeve në vijimësi.

Pyetje: A mund të na thoni disa shifra konkrete për investimet e realizuara në qarkun e Dibrës gjatë periudhës që Ju jeni Prefekt dhe ndonjë krahasim nëse keni një analizë për këtë problem?

Përgjigje: Po. Mund të flasim me shifra pasi një ndër prioritet e adminitsratës që drejtoj ka qenë dhe puna studimore në të gjitha fushat. Vijmë tani te thelbi i pyetjes Suaj.

Në periudhën nga viti 1997 deri në vitin 2005 në qarkun e Dibrës në total janë realizuar 6.236.655.000 lekë investime. Ndërsa për vitet 2006 dhe 2007 janë realizuar 1.852.409 000 lekë investime dhe 274.731. 000 lekë ka shkuar realizimi i 7 mujorit janar – korrik 2008, kur plani vjetor i deritanishëm është 944.827. 000 lekë. Themi plani i deritanishëm, pasi planet e investimeve shtohen vazhdimisht.

Pyetje: Cilat janë disa nga problematikat që hasen në këtë rajon dhe si i keni ndjekur Ju ato, si keni dhënë ndihmesë për zgjidhje?

Përgjigje: Në takimet mujore me drejtues të institucioneve qëndrore në nivel vendor, duke marrë pjesë vetë në analizat mujore, 6 mujore apo vjetore të institucioneve, nga kontaktet e drejtpërdrejta apo nëpërmjet informacioneve me shkrim nga vetë qytetarët, nga vëzhgimi i përditshëm dalin dhe shumë probleme që nuk kanë lindur sot, as gjatë qeverisjes së pas 3 korrikut 2005.

Problemet fillojnë që me infrastrukturën, kujdesin për rrugët në situatat emergjente, marrja e masave nga strukturat e KESH – it për të realizuar furnizim normal me energji, probleme të arsimit, shëndetësisë, rendit, kufirit, furnizimit me ujë etj.

Pyetje: Po si ka ndikuar institucioni i Prefektit në amortizimin e problemeve të përditshme?

Përgjigje: Në çdo analizë dhe për secilin sektor Prefekti ka vlerësuar arritjet dhe kurdoherë ka kërkuar çuarjen e tyre përpara, gjithmonë ballafaquar me atë se çfarë kërkon Qeveria në programin e saj, duke kërkuar plane konkrete pune me afate dhe detyra të përcaktuara qartë.

Për ta vënë institucionin në shkallën maksimale të efekteshmërisë së punës, nga të gjithë punonjësit e zyrave dhe sektorëve kam kërkuar njohjen cilësore të ligjit , forcimin e vazhdueshëm të disiplinës shkencore në punë, bashkëpunim efikas për hartimin e strategjive rajonale të zhvillimit social – ekonomik, ndjekje të vazhdueshme të plotësimit të treguesve të buxhetit, kontroll për situatën e shpenzimeve buxhetore të organeve të qeverisjes vendore sipas zërave të miratuar, dhënie asistence juridike, zgjidhje në kohë të kërkesave dhe ankesave të popullit, ndërhyrje ligjore për zgjidhje mosmarrëveshjesh mes institucionesh vetëm sipas kompetencave, kujdes maksimal në kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë nga organet e qeverisjes vendore nëpërmjet vendimeve që ata marrin.

Kontrolli ligjor i këtyre vendimeve, marrja e tyre sipas ligjit, vënia në dukje e mangësive, në rastet kur ato janë marrë në kundërshtim me ligjin, ka qenë dhe mbetet prioritet i punës së Prefektit, pasi në këndvështrimin tim, të bërë publik, nuk mund të pretendohet për shtet ligjor nëse organet e zgjedhura apo kushdo tjetër do të marrin e zbatojnë vendime në kundërshtim me ligjin.

Me shkresa të veçanta të argumentuara u jam drejtuar Instancave përkatëse qeveritare për nevojën e investimeve konkrete në këtë trevë dhe nevojën e nisjes së procedurave për ta futur Parkun Kombëtar të Lurës në planet mbrojtëse të UNESKOS, duke dhënë dhe arsyet shkencore se pse duhet bërë një gjë e tillë.
Ajo që të bën përshtypje jo të mirë sa më sipër ka të bëjë me faktin, që ndërsa vetë Kryeministri u drejtohet Ministrive të linjës për të vlerësuar problemet që ngremë në shkresat tona sa i takon zhvillimit të turizmit në përgjithësi dhe në zonën e Lurës në veçanti, intelektualët dibranë që banojnë në Dibër, apo në Kryeqytet, mendoj se shumë pak e ngrenë zërin për këtë problem.

Po kështu detyra konkrete janë shtruar për zyrat që mbulojnë shërbimet publike ndaj popullsisë si elektrikun, telekomin, postën, bujqësinë, punësimin, shërbimin social, infrastrukturën, investimet, urbanistikën, ndërtimet, muzetë, turizmin, arsimin, kulturën, shëndetësinë, rendin, mbrojtjen, problemet e emergjencës civile, gjendjes civile, PMNZSH – së etj. Kam konsideruar prioritet të punës dhe rritjen e efiçensës së punës së nënprefekturave në Mat e Bulqizë, duke kërkuar nga nënprefektët dhe administrata e tyre të bëhen pjesë e zgjidhjes së problemeve, të jenë më afër njerëzve e problemeve të tyre, të afrojnë shërbime sipas ligjit pa i sorrollatur ata për të ardhur te Prefekti për një problem të thjeshtë duke bërë dhjetra kilometra rrugë.

Shqetësimet e banorëve në rajonin e Dibrës janë bërë të njohura për Prefektin, jo vetëm në takimet javore të planifikuara për pritjen e tyre çdo ditë të martë, por në mënyrë periodike, pa i penguar ata të bëjnë takim dhe në ditët që nuk janë caktuar si ditë pritjeje, edhe në zona, në komuna apo bashki, kur kërkesa për takim e çdo qytetari është mirëpritur dhe në çdo rast ka pasur vëmendjen e duhur për tu dëgjuar.

Vlerësimin tim maksimal kanë pasur mbledhjet e organeve të qeverisjes vendore, ndaj për probleme të rëndësishme kam marrë pjesë vetë në mbledhje të këshillave të komunave apo bashkive dhe bashkë me ta ka qenë vëmendja ime e përherëshme për punë cilësore dhe sistematike në gjendjet civile në tërë problematikën e tyre, që kohët dhe vitet e fundit ka qenë e ngjeshur.

Më lejoni thjesht të përmend disa statistika: Komunikimi shkresor me institucionet dhe qytetarët ka qenë në nivelet më të larta. Kështu nga 7 tetori 2005 deri më 31 dhjetor 2005 në Institucionin e Prefektit kanë hyrë gjithsej 700 shkresa të llojeve të ndryshme dhe kanë dalë 830 të tilla. Për vitin 2006 shkresat e hyra kapin shifrën 2765, ndërsa ato që kanë dalë janë 5167, për vitin 2007 numërohen 3500 shkresa të hyra dhe 4600 të dala, për 6 mujorin e parë 2008 kanë hyrë në institucion 1500 shkresa dhe kanë dalë prej tij 2600 të tilla. Për gjithë periudhën janë 8465 shkresa të hyra dhe 13197 të dala nga institucioni i Prefektit të qarkut Dibër. Një komunikim masiv, që tregon ndër të tjera dhe besimin e krijuar te ky institucion.

Pyetje: Si po veproni ju për perfeksionimin e punës së vetë administratës suaj?

Përgjigje: Në këndvështrimin tim një punë e mirë, mund të realizohet vetëm nga njerëz të aftë profesionalisht, njerëz që e duan punën, por dhe që janë të arsimuar. Janë pikërisht kërkesa dhe të Kryeministrit të Shqipërisë të bëra disa herë publike dhe që tregojnë imazhin e Tij për administratën që i nevojitet këtij vendi në stadin e tanishëm të zhvillimit me synime të qarta për aderim në NATO dhe Bashkimin Evropian.

Në vazhdim të idesë më lejoni të paraqes pak fakte: në administatën vendore të 31 komunave e 4 bashkive nga 766 të punësuar, 97 janë me arsim 8 vjeçar, 409 me të mesëm dhe vetëm 260 me të lartë, apo nga 503 anëtarë këshilli në komuna e bashki, 77 janë me arsim fillor e 8 vjeçar, 261 me të mesëm dhe 165 me të lartë. Kjo më ka detyruar të artikuloj shpesh për drejtuesit e organeve të qeverisjes vendore kërkesën për përzgjedhje profesionale të të punësuarve, ndërsa niveli i ulët arsimor i këshilltarëve ka mbetur thjesht një konstatim që lë shije të hidhur, i cili për t'u përmirësuar mbetet edhe për të ardhmen në dorën e subjekteve politike, në përzgjedhjen që bëjnë ata gjatë renditjes në listat e kandidaturave për anëtarë në këshilla të personave të parapëlqyer.

E pra, në këto kushte, kur kërkoj nga të tjerët, me aq sa më lejon ligji, që të krijojnë një administatë profesionale, nuk ka se si të mos kërkoj te vetja ime. Me moton: " T'i gjejmë punës njeri e jo njeriut punë" mendoj se kam arritur të kem një administratë tërësisht profesionale, me specialistë të aftë e të përkushtuar për punën, që e dinë punën e tyre, që nuk kanë nevojë për shtytje e ngucje, apo t'u rrish mbi kokë, por gjithësecili bën normalisht punën e tij.

Pyetje: Ky qëndrim i juaji ndaj profesionalizmit mendoni se është mirëkuptuar nga të tjerët?

Përgjigje: Varet se kë nënkuptoni me të tjerë. Nëse bëhet fjalë për të paformuarit, ata që u ka mbetur ora prapa, nuk ia vlen të flasësh. Çdo njeri me dy gram tru në kokë duhet ta kuptojë se vendi ndërtohet dhe shkon para me specialistë të aftë. Kush mbetet te koha e biografisë ka akoma nevojë të vetëpastrohet nga mentalitetet.

Ajo, që është pjesë e punës dhe karakterit tim, që më përket mua, ka të bëjë me faktin që kam përcjellë kurdoherë mesazhe mirëkuptimi e bashkëpunimi, larg urrejtjeve paradoksale të shprehura në ndonjë rast në qëndrime meskine e dashakeqe, duke besuar plotësisht se e drejta, sinqeriteti dhe cilësitë e larta morale të karakterit nuk mund të zhbëhen e tjetërsohen, ato janë të denja për t'u vlerësuar edhe nëse dikush nuk ka dëshirë t'i vlerësojë.

Pyetje: Cilat mendoni se janë nevojat më imediate në qark?

Përgjigje: Vazhdimisht kam vënë theksin në nevojat më imediate që mund të zgjidhen me investime në qarkun e Dibrës me ndihmë dhe të donatorëve si:

- Në infrastrukturën e rrugëve Nacionale e Rurale; në fuqizimin e nënstacioneve elektrike, përfundimin e vënies së matësave, gjetja e burimeve te reja energjitike, vënia në punë e H/

intervistë

PREFEKTI SEITI: *Ka diçka për të përmirësuar ligjërisht sa u takon përcaktimeve se kush duhet të merret konkretisht me veprimtaritë kulturore dhe artistike si në komuna, ashtu dhe për koordinimin në rrethe*

Duke qenë dakord me mendimin e njëzëshëm të të gjithë faktorëve në qarkun e Dibrës, përcaktuam prioritet të prioriteteve për qarkun Dibër, ndërtimin e rrugës Peshkopi – Tiranë në aksin e quajtur Rruga e Arbërit dhe për këtë me shkresa zyrtare, iu drejtuam Kryeministrit të Shqipërisë, Ministrit të Punëve Publike dhe Transporteve, Ministrit të Financave, Ministrit të Brendshëm dhe 14 Deputetëve, për t'i sensibilizuar me faktin e pamohueshëm se ndërtimi i kësaj rruge e nxjerr Dibrën nga izolimi i sotëm, e afron atë me Tiranën e gjithë Shqipërinë.

centraleve lokalë apo ndërtim H/centralesh me kushte lehtësuese; në strehimin e qytetarëve të pastrehë, problem për të cilin në qarkun e Dibrës nuk është investuar pothuajse fare që nga viti 1996 dhe vetëm kjo qeverisje ka planizuar këtë vit 24 banesa për qytetin e Peshkopisë, të cilat prapëseprapë mendoj se janë pak ; në sistemin ujitës dhe atë kullimit në bujqësi, për ndërtim punishtes për përpunimin e produkteve bujqësore e blegtorale, veçanërisht në zona ku baza kryesore e jetesës është blegtoria dhe shëndoshjen e blegtorisë ; për rikonstruksione shkollash, ndërtime të reja, pajisje me mjete, bazë materiale e laboratorike; për ndërtime ambulancash në fshatra dhe rikonstruksion të disa qendrave shëndetësore ; për përfundimin e pallatit të sportit në Peshkopi filluar që në vitin 1986, por që përfundon këtë vit nën kujdesin e drejtpërdrejtë të vetë Kryeministrit; për sistemin e *Kanaleve të Ujrave të Zeza e të Bardha* në qytete e fshatra; *fuqizimin e ujësjellësave* në qytete dhe ndërtime të reja në fshatra; përfundimin e *Ujësjellësit të Sopanikës* në Dibër, vënien në punë të asaj pjese që ka përfunduar dhe kujdesi për të ndër të tjera dhe me ngritjen e një SH.A. – je të posaçme; *sistemim – asfaltim në qytete dhe zonat rurale;* ngritjen e një sistemi të qëndrueshëm të turizmit malor; nxitjen e punësimit, ndër të tjera dhe kthimin e ndihmës ekonomike në programe punësimi në komunitet; vënien në funskion të plotë të pikës kufitare të Bllatës, e cila vazhdon të jetë jashtë kushteve më minimale përsa i përket infrastrukturës; krijimin e kushteve për punë dhe pajisjen me bazë materiale në organet e qeverisjes vendore dhe në disa institucione qëndrore në nivel vendor, rritjen e efiçensës së menaxhimit të integruar të kufijve në kudrin e përgjithshëm të integrimit të Shqipërisë në NATO, duke parashtruar për Qeverinë dhe kërkesa modeste për nevojat për uniformat e policisë kufitare, makinat për lëvizje, mjediset e bollshme e të kulturuara etj.

Duke qenë dakord me mendimin e njëzëshëm të të gjithë faktorëve në qarkun e Dibrës, të intelektualëve, specialistëve, drejtuesve të organeve të qeverisjes vendore, biznesmenëve e njerëzve të thjeshtë, përcaktuam prioritet të prioriteteve për qarkun Dibër, ndërtimin e rrugës Peshkopi – Tiranë në aksin e quajtur *Rruga e Arbërit* dhe për këtë me shkresa zyrtare, ku jepeshin argumenta për nevojën dhe përparësitë që ka qarku i Dibrës me ndërtimin e kësaj rruge, *iu drejtuam Kryeministrit të Shqipërisë, Ministrit të Punëve Publike dhe Transporteve, Ministrit të Financave, Ministrit të Brendshëm dhe 14 Deputetëve*, që kanë njohuri për Dibrën dhe janë të lidhur me komunitetin e kësaj treve, për t'i sensibilizuar me faktin e pamohueshëm se ndërtimi i kësaj rruge e nxjerr Dibrën nga izolimi i sotëm, e afron atë me Tiranën e gjithë Shqipërinë. Premtimi i Qeverisë Shqiptare dhe Kryeministrit sot po bëhet realitet.

Pyetje: Si ka qenë bashkëpunimi dhe bashkërendimi i punës suaj me Instancat e larta qeveritare, por dhe me organet e qeverisjes vendore?

Përgjigje: Duke u njohur në mënyrë të plotë me problemet, kam dalluar dhe ato probleme që nuk varen e nuk mund të zgjidhen në organet e qeverisjes vendore dhe institucionet qëndrore në nivel vendor, por kërkojnë dhe ndihmën e Shtetit nëpërmjet Ministrive sipas përkatësisë. Ndaj detyrë e Prefektit ka qenë rritja dhe realizimi i bashkëpunimit në nivele të kënaqshme me të gjitha Ministritë si Ministrinë e Punëve Publike, Transporteve e Telekomunikacionit, me të cilën bashkëpunimi është përqëndruar në nevojat më imediate dhe prioritare për investime në qarkun e Dibrës, Ministrinë e Mbrojtjes, kryesisht për probleme të mobilizimit ushtarak, Ministrisë së Punës,Çështjeve Sociale e Shanseve të Barabarta, ku ndër të tjera është argumentuar nevoja e përdorimit të ndihmës ekonomike për punësim në komunitet gjë do të sillte shmangien e përfitimit të paligjshëm të kësaj ndihme nga familje që nuk u takon, por arrijnë të plotësojnë dokumentacionin e kërkuar për t'u trajtuar me këtë ndihmë, Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, ku ndër të tjera kemi bashkërenduar për nevojën e vazhdimit të financimit të skemave ujitëse dhe kullimit në qarkun e Dibrës, nisur nga fakti që shoqatat e ujit akoma nuk janë konsoliduar, nxitjen e investimeve private me kredi lehtësuese, Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës për probleme të organizimit më të mirë të punës në strukturat e K.E.SH- it si për një furnizim normal me energji elektrike të popullsisë, ashtu edhe për likuidimin e saj nga konsumatorë të ndryshëm, Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, kryesisht për probleme dhe nevoja të arsimit në qarkun e Dibrës, për mbarëvajtjen e arsimit të mesëm, veçanërisht atij profesional, për nevojat e argumentuara për investime në objekte shkollore, Ministrinë e Shëndetësisë për probleme të ecurisë së këtij sektori, vënien në efiçensë të strukturave të shumta drejtuese nëpërmjet përcaktimit konkret të detyrave të secilës strukturë dhe realizimin e bashkëpunimit mes tyre, Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për nevojën e vënies në efiçensë të objekteve kulturore e sportive të filluara para një dekade, por të papërfunduara dhe nisjen e investimeve për zhvillimin e turizmit gjë për të cilën qarkut të Dibrës nuk i mungojnë resurset etj.

Më lejoni këtu të ndalem pak te një nga kryeveprat natyrore jo vetëm për rajonin, por për gjithë Shqipërinë e më tej, siç është Lura, në tërë hapësirën e saj, me Parkun Kombëtar, liqenjtë e mrekullueshëm, pyjet, lëndinat, ujin e ftohtë, klimën e mrekullueshme. Me shkresa të veçanta të argumentuara u jam drejtuar Instancave përkatëse qeveritare për nevojën e investimeve konkrete në këtë trevë dhe nevojën e nisjes së procedurave për ta futur Parkun Kombëtar të Lurës në planet mbrojtëse të UNESKOS, duke dhënë dhe arsyet shkencore se pse duhet bërë një gjë e tillë.

Ajo që të bën përshtypje jo të mirë sa më sipër ka të bëjë me faktin, që ndërsa vetë Kryeministri u drejtohet Ministrive të linjës për të vlerësuar problemet që ngremë në shkresat tona sa i takon zhvillimit të turizmit në përgjithësi dhe në zonën e Lurës në veçanti, intelektualët dibranë që banojnë në Dibër, apo në Kryeqytet, mendoj se shumë pak e ngrenë zërin për këtë problem.

Natyrisht kryefjalë e bashkëpunimit ka qenë për ne Ministria e Brendshme, të cilën në mënyrë figurative mund ta quajmë dhe Ministri e frymëmarrjes sonë, pasi aty, në atë Ministri është pika e lidhjes sonë me të gjitha Ministritë e tjera.

Në qendër të punës sime si Prefekt ka qenë e vazhdon të jetë dhe nxitja e bashkëpunimit mes organeve të qeverisjes vendore dhe institucioneve qëndrore në nivel vendor, institucione këto me të cilat puna e Prefektit është e lidhur ngushtësisht dhe në kuptim të ligjit.

Në çdo takim të përbashkët apo të veçantë Prefekti e ka kërkuar një gjë të tillë. Edhe në Urdhërat e nxjerra pas çdo mbledhjeje të organit këshillues, një nga pikat ka qenë rritja e këtij bashkëpunimi.

Natyrisht që çdo punë ka dhe mangësitë e saj, ndaj dhe sa i takon bashkëpunimit, kryesisht me Ministritë dhe Drejtoritë Qëndrore, mendoj se ka akoma për të bërë veçanërisht në të kuptuarit më të drejtë të faktit që ligji " Për Prefektin" vërtet është një ligj që përcakton se si duhet të funksionojë ky institucion, por njëkohësisht në të gjejnë vend dhe detyra e detyrime dhe për vetë Ministritë për probleme të informimit që këto të fundit duhet të bëjnë për Prefektin sa u takon akteve që nxjerrin, investimeve që planifikojnë, kontrolleve që ushtrojnë në linjat e tyre, por dhe për emërimet e drejtorëve në institucionet qëndrore në nivel vendor, të cilat janë paracaktuar në ligj që në çdo rast duhen bërë me propozim të Prefektit e të tjera.

Pyetje: A është kultura, zhvillimi i saj në axhendën e punës Suaj?

Përgjigje. Natyrisht që po. Vërtet nuk ka struktura specifike që të merren me kulturën dhe sportin, kryesisht në komuna, por ka zyra apo seksione që mbulojnë këto probleme së bashku me ato të arsimit.

Vlerësim të veçantë jam munduar të bëj për historinë e qarkut, për mirëmbajtjen e monumenteve të kulturës.

Me vlera mendoj se është hartimi i historikut të Prefekturës në Dibër brenda një viti nga koha e emërimit tim si Prefekt. Këtu më lejoni të shtoj se më dukej i papranueshëm fakti që dhe intelektualë të mirëformuar nuk kishin asnjë dijeni ose dinin fare pak për historinë e Prefekturës dhe nëprefektuarave në qarkun e Dibrës. Më dukej absurd fakti që pyetjes së mdonjë të huaji, ambasadori apo donatori për diçka mbi historinë e Prefekturës së Dibrës t'i përgjigjeshe me rrudhje supesh. Ndaj qe ndër të parat detyra që inicova, realizimi i një historiku për Prefekturën Dibër me të dhëna arkivore për krijimin, ecurinë në dekada deri në ditët e sotme. Ndërsa historiku u realizua brenda gushtit të vitit 2006, një pjesë e tij u afishua në hollin e Institucionit, mendoj se puna nuk mbaron këtu. Nuk mbaron këtu qoftë sa i takon thellimit dhe përsosjes së studimit në këtë fushë, ashtu dhe më kryesorja gjetja e burimeve financiare shtetërore për botimin e këtij historiku pasi do t'u shërbejë brezave. E them këtë pasi kam menduar dhe mendoj që njohja e vendlindjes duhet të jetë përparësi duke filluar që nga shkollat, kur jepen njohuritë fillestare, njohja me vendlindjen, në këndvështrimin tim, duhet të fillojë te vendlindja më e afërt për të kaluar më pas te Atdheu.

Në vemendjen time ka qenë vazhdimisht pjesëmarrja në të gjitha veprimtaritë pëkujtimore, në takime të ndryshme për ngjarje historike apo figura të shquara, kujdesi për O.J.Q – të, klubet sportive të të gjitha moshave e mediat, duke u munduar të nxis financimet për to; të rris interesimin për shoqatat e njerëzve në nevojë, kryesisht të jetimëve, të të verbërve, të invalidëve, sindikatat, ku kam synuar të dëgjoj me vemendje shqetësimet e grupeve të interesit duke u përpjekur të ndihmoj në gjetjen e zgjidhjeve sa më të drejta e ligjore.

Shpreh mendimin se ka diçka për të përmirësuar ligjërisht sa u takon përcaktimeve se kush duhet të merret konkretisht me veprimtaritë kulturore dhe artistike si në komuna ashtu dhe për koordinimin në rrethe, pasi për bashkitë në një fare mënyrë është e përcaktuar.

Natyrisht, edhe sipas përcaktimeve në ligj, roli i Prefektit është bashëpunues, nxitës dhe në asnjë rast urdhërues, gjë që bën domosdoshmëri gjetjen e gjuhës së mirëkuptimit për çdo problem që i shërben çështjes së përbashkët, rritjes së mirëqenies së komunitetit.

Bisedoi: Shaqir Skarra

KRYEMINISTRI SALI BERISHA VIZITON MATIN

Së shpejti do të fillojë ndërtimi i Rrugës së Arbrit në trajektoren e saj të plotë

Kryeministri Sali Berisha, në vijim të turit "Shqipëria po ndryshon", ishte javëne fundit të shtatorit në Mat.

Ai vizitoi bashkinë e Klosit, komunën e Bazës dhe qytetin e Burrelit, ku përuroi disa vepra të rëndësishme në infrastrukturë dhe arsim.

Në të gjitha takimet e tij, kryeministri Berisha foli për Rrugë e Arëbrit. "Një seri rrugësh, janë në projekt për asfaltim në zonën e Klosit, ndër të cilat rruga që ju shkurton lidhjen me Tiranën, Rruga e Arbrit që është edhe projekti më madhor. Ajo po ecën. Ne nuk e harrojmë këtë rrugë. Unë nuk i kam harruar dhe nuk do t'i harroj premtimet e mia. Të gjitha do t'i shndërrojmë në realitet."

"Së shpejti do të fillojë ndërtimi i Rrugës së Arbrit në trajektoren e saj të plotë. Nga kjo rrugë, banorët e Klosit janë ata që përfitojnë më shumë. Kryetari i bashkisë më thotë se përmes kësaj rruge shkurtohet shumë distanca dhe rruga deri në Tiranë bëhet për 40 kilometra. Në këtë mënyrë, Klosi bëhet një zonë shumë e rëndësishme për të gjithë pasurinë që ka por edhe vlera të mëdha në përmirësimin e transportit . – theksoi ai.

Po ashtu, edhe në Burrël, kryeministri e vuri theksin mbi Rrugën e Arbërit. "Unë i premtova kryetarit të bashkisë investimin e rrugës që zbret në autostradë dhe të nisë projekti dhe për rrugën tjetër që lidh Klosin me Tiranën. Këtë vit fillon segmenti Klos - Bulqizë dhe Bulqizë – Klos".

Gjatë kësaj vizite, Kryeministri foli edhe për infrastrukturën rurale në këtë rreth. "Është e domosdoshme që të ndërtohen rrugët aq të rëndësishme për këtë zonë, është e domosdoshme që të bëhet me përparësi projekti i rrugës që ndjek trajektoren e hekurudhës që është rruga që nxjerr Matin më shpejt në autostradë, por ndërkohë rruga tjetër të mbetet për të lidhur fshatrat", theksoi kryeministri.

Gjatë vizitës në rrethin e Matit, Kryeministri Berisha ishte i pranishëm në inaugurimin e fillimit të punimeve për kanalin ujitës në Klos, investim me vlerë 130 milion lekë. Kanali me gjatësi 28 km do të ujisë një sipërfaqe prej 1200 ha në bashkinë Klos dhe disa komuna të saj.

Po ashtu, Kryeministri inauguroi edhe ujësjellësit e fshatit Bejnë dhe ujëmbledhësin e fshatit Bazë. Ujësjellësi i Bejnës është investim i buxhetit të shtetit me vlerë 30 milionë lekë, dhe furnizon me ujë mbi 1200 banorë të kësaj zone. Ndërsa ujëmbledhësit i Bazës, investim i buxhetit të shtetit me vlerë 65 milionë lekë, garanton vaditjen e rreth 400 ha tokë në këtë zonë.

Gjithashtu, Kryeministri mori pjesë në ceremoninë e nisjes së punimeve për rikonstruksionin e plotë të shkollës së mesme "Pjetër Budi" si dhe në ceremoninë e inaugurimit të universitetit privat "Nëna Mbretëreshë Geraldinë" në Burrel.

Pengesat që i shkaktuan kufiri dhe pasaportat i mposhti dasma dibrane në Gjakovë, i mposhti dëshira për t'u gëzuar dhe jetuar bashkë, dëshira për të vazhduar traditën e krijimit të miqësive të reja mes Dibrës së Madhe dhe Kosovës.

Dasma dibrane në Gjakovë

Nga **Rexhep TORTE**

DASHURIA QË I SFIDOI PENGESAT

Edhe kjo verë në trojet shqiptare u karakterizua me dasma dhe ahengje, si rast i vetëm për t'u mbledhur tok familjet, farefisi, shokët dhe miqtë nga të gjitha anët, ku më shumë spikati prania dhe çmallja me mërgimtarët.

Në Dibër të Madhe pati qindra dasma, por gjithsesi duhet veçuar dasma e mërgimtarit dibrano-amerikan Mensur Bekteshi, i cili tashmë dhjetë vite jeton me familjen e tij në Nju Jork të SHBA-ve dhe dasmën e djalit të tij Blendi e bëri në Gjakovë.

Të enjten mbrëma, përkatësisht më 28 gusht 2008, në sallën e madhe të hotelit Pashtriku në Gjakovë, të dekoruar dhe aranzhuar me pikanteri magjepëse, të mbushur përplot me dasmorë dibranë, gjakovarë dhe të ftuar tjerë, mes tyre edhe miqtë nga Mitrovica, me zërin e këngëtarit të mirënjohur Shkëlzen Jetishi - Xeni dhe muzikën e orkestrit të tij, u mbajt dasma dibrane në Gjakovë.

HISTORIKU I DASMËS DIBRANE NË GJAKOVË

Dibranin Mensur Bekteshi dhe familjen e tij, agresioni serb ndaj Kosovës në vitin 1999 e gjeti në Prishtinë, ku jetonte dhe punonte. I gjendur në një situatë të vështirë si edhe shqiptarët e tjerë nga Kosova, për t'a shpëtuar veten dhe familjen nga plumbat dhe bajonetat serbe, familjarisht iu bashkangjit eksodit të kosovarëve dhe kaloi në Tiranë. Pas një kohe nga Tirana arrin në vendlindje, në Dibër të Madhe dhe nga Dibra e Madhe bashkë me shumë kosovarë mërgon për në SHBA, ku edhe sot e kësaj dite jeton sëbashku me bashkëshorten, Dashen dhe me fëmijët, Brikendin, Blendin dhe Brikenën.

Edhe kjo verë në trojet shqiptare u karakterizua me dasma dhe ahengje, si rast i vetëm për t'u mbledhur tok familjet, farefisi, shokët dhe miqtë nga të gjitha anët, ku më shumë spikati prania dhe çmallja me mërgimtarët.

BLENDI GJURMËVE TË BABAIT

Mensur Bekteshi gjatë studimeve në Prishtinë u njoh me gjakovaren Dashnore - Dashe Rogovën. Mes tyre lindi një dashuri e zjarrtë dhe e sinqertë, e cila në vitin 1976 u kurorëzua me martesën dhe dasmën që u mbajt në Dibër të Madhe. Dhjetëra vetura me krushq dibranë asokohe vajtën dhe e morën nusen e Mensurit në Gjakovë. Kështu familja e Shuip Bekteshit, babait të Mensurit nga Dibra e Madhe dhe familja e Halil Rogovës nga Gjakova lidhën miqësinë dhe krushqinë e tyre.

Traditën e babait e vazhdoi edhe Blendi Bekteshi, i cili kohë më parë u njoftua dhe ra në dashuri me mitrovicasen Taulanta Jakupi, e cila gjithashtu jeton në SHBA.

Dilemat nëse dasma e dibranit Blendi Bekteshi me mitrovicasen Taulanta Jakupi, do të mbahet në Dibër të Madhe ose në Gjakovë, i solli kufiri dhe mungesa e pasaportave që ende nuk i ka marrë një pjesë e madhe e kosovarëve.

Familja Bekteshi, fillimisht e kishte vendosur që dasmën e Blendit ta bëjnë në Dibër të Madhe, por duke e ditur se nga mospasja e pasaportave një pjesë e madhe e miqve dhe shokëve nga Gjakova e Kosova nuk do të mund të udhëtonin për në Dibër në Madhe, u vendos që dasma dibrane të mbahet në Gjakovë.

Me që dibranët e ftuar për në dasëm nuk kishin probleme me pasaportat, familja Bekteshi, për tua lehtësuar pjesëmarjen ua siguroi hotelin dhe tranpsortin nga Dibra e Madhe për në Gjakovë.

DASMA QË I SFIDOI PENGESAT

Pengesat që i shkaktuan kufiri dhe pasaportat i mposhti dasma dibrane në Gjakovë, i mposhti dëshira për t'u gëzuar dhe jetuar bashkë, dëshira për të vazhduar traditën e krijimit të miqësive të reja mes Dibrës së Madhe dhe Kosovës. Në këtë dasëm u kënduan këngë dibrane, mes tyre edhe e Hajredin Pashës, u kënduan këngë kosovare, shkodrane dhe shumë këngë të tjera që enthuziazmuan dasmorët deri në orët e mëngjesit.Të pranishmit në këtë dasëm u bindën edhe njëherë për afërsinë e traditës dibrano-gjakovare dhe u kënaqën duke kënduar dhe vallzuar, duke uruar jetë të lumtur për çiftin e ri, forcimin e miqësisë mes këtyre dy familjeve dhe vazhdimin e kësaj tradite edhe në të ardhmen.

LAJME

Rruga Librazhd - Steblevë - Shupenzë, mbaron loti i parë

Më me 6 shtator, në prani të Kryeministrit Sali Berisha, ministrave Olldashi dhe Bode, 1 km në dalje të Librazhdit, në rrugën Librazhd-Dibër u bë përurimi i fillimit të sistemimit dhe asfaltimit të kësaj rruge me rëndësi të madhe kombëtare.

"Ndodhemi në pikën më nevralgjike të Shqipërisë lindore, tha zoti Sali Berisha në fillim të fjalës së tij të shkurtër, në këtë takim pune me banorët e kësaj zone. Kjo rrugë bashkon Librazhdin me Dibrën, Shqipërinë me Maqedoninë dhe të gjithë zonën verilindore. Kjo rrugë e standarteve bashkëkohore, 6 metra e gjërë do të rrisë begatinë dhe mirëqënien e këtyre njerëzve të mrekullueshëm".

Kryeministri porositi të ecet më shpejt me tenderimet, pasi fondet janë gati, projekti deri në Studen, 23 km, gjithashtu është gati, të ndahen drejt lotet dhe në mënyrë përpjestimore dhe deri në fund të këtij viti të shkojë rruga deri në Fushë-Studen dhe vitin tjetër deri në Shupenzë. Kjo rrugë bashkë me projektin e Parkut Kombëtar që përfshin katër komuna dhe 33927 hektarë pyje do të përmirësojë infrastrukturën dhe mirëqënien e kësaj zone.

S. Cami

Zona pyjore Shebenik - Jabllanicë shpallet Park Kombëtar

Këshilli i Ministrave, me vendim të veçantë miratoi në mbledhjen e tij të datës 21 maj 2008 shpalljen park kombëtar të ekosistemit natyror Shebenik - Jabllanicë. Në zonën e Steblevës ky park shtrihet në zonën Llangë, Fushë Studën, Borovë në kuotën 887 m, ndjek përroin e Zallit të Klenjës, ndërpret rrugën automobilistike Steblevë-Klenjë në kuotat 1328 m, 1462 m, 1484 m, 1778 m.

Me datë 2 shtator 2008 në Fushë Studën, komuna e Steblevës, u bë përurimi i këtij parku kombëtar që përfshin 33927 hektarë pyje të shtrira në zonat administrative të katër komunave.

Për komunën e Steblevës ka patur një projekt për përmirësimin dhe mirëadministrimin e pyjeve që nga viti 1999 e deri në vitin 2008 që përfshinte 1800 hektarë pyje dhe 2500 hektarë kullota. Shpallja e këtij parku kombëtar nga Qeveria ishte frut i përpjekjeve edhe të komunitetit të Steblevës dhe të shoqatës "Stebleva" të cilët kanë disa vjet rresht që përpiqen për mbrojtjen e pyjeve të tyre.

"Krahas me parkun kombëtar vazhdon asfaltimi i rrugës Librazhd-Steblevë që do të vazhdojë deri në Dibër, vazhdon puna për ndërtimin e hidrocentralit të Steblevës dhe investime të tjera të qeverisë. Ta ruani këtë pasuri të madhe nga vjedhjet, dëmtimet, djegjet dhe nga shfrytëzimi pa kriter se vetëm kështu do të arrini që ta ktheni këtë zonë të bukur e të virgjër natyrore me ajër të patër dhe ujëra të mrekullueshme në zonë turistike dhe do të rrisni të ardhurat tuaja", tha Ministri i Mjedisit, Lufter Xhuveli në takim me përfaqësues të shoqatës "Stebleva".

Kryetari i komunës Xhavit Boriçi pasi vlerësoi vendimin e Qeverisë dhe projektin e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe administrimit të Ujërave, premtoi se komuniteti i Steblevës dhe i fshatrave të kësaj komune do të ruajnë dhe do ta zhvillojnë edhe më shumë park sepse është parku i tyre, është toka e tyre për mbrojtjen e së cilës të parët e tyre kanë derdhur gjak . Në këtë ceremoni mori pjesë edhe kryesia e Shoqatës Stebleva e përbërë nga zotërinjtë Mersin Hoxha, Dilaver Abazi, Ali Fejza, Arif Tamizi dhe Hajredin Kurti.

S. Cami

"Ratia Energie" pjesë e konsorciumit për ndërtimin e Skavicës

Kryeministri Berisha priti dje në një takim përfaqësuesit e kompanisë KINGLOR SRL, të cilët prezantuan partnerin e ri të konsorciumit që do të marrë pjesë në projektin për ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës.

Kompania që hyn në këtë konsorcium është "Ratia Energie" e kryesuar nga Fabio Bocciola. Përfaqësuesit e dy kompanive shprehën angazhimin e tyre që si konsorcium të arrijnë maksimumin në këtë projekt, për të cilin do të nisë procedura e tenderimit.

Kryeministri Berisha i përgëzoi investitorët për këtë sipërmarrje dhe i siguroi se procesi i përzgjedhjes së projektit për ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës do të jetë transparent dhe profesional duke mbrojtur njëkohësisht interesin publik dhe atë të bisnesit.

Mat, banorët shtrojnë vetë rrugën

Banorët e komunës Frankth në rrethin e Matit kanë mundur të realizojnë vetë atë që shumëkush ua ka premtuar, por nuk u a ka realizuar. Një rruge që të lidhë shtëpitë e tyre me akset nacionale.

Duke mos pritur që pushteti lokal dhe ai qendror të nisin tenderime për ndërtimin e kësaj rruge, banorët e kanë financuar vetë ndërtimin e saj dhe e kanë ndërtuar vetë. Siç tregojnë edhe vete ata, një ndihme e madhe kanë qenë të ardhurat që të afërmit në emigracion kanë dërguar paratë për ndërtimin e kësaj rruge të re. Banorët tregojnë, se kanë punuar vetë për hapjen e trasesë së rrugës dhe shtrimin e saj. Ata thonë, se nuk mund të prisnin realizimin e premtimeve që ju bëhen në çdo fushatë elektorake, por që nuk mbahen nga askush.

aktualitet

Këshilli Bashkiak i Komunës së Dibrës së Madhe shpall qytetar nderi pronarin e fabrikës së Gjipsit, Nikolas Knauf, por qytetarët nuk janë dakord. Shoqata "Onë USD for Dibra" realizon një sondazh në internet, ku 75% janë kundra. Kush gabon?

NË CEREMONI SOLEMNE NË DIBËR TË MADHE

Nikolas Knauf u shpall Qytetar Nderi

Nikolas Knauf është themelues dhe bashkëpronar i grupacionit të madh ndërkombëtar Knauf, i cili në 40 shtete të botës ka 150 fabrika ku janë punësuar 20 mijë punëtorë dhe ka një xhiro vjetore prej 7 miliardë dollarë.

Në foto: Nikolas Knauf duke marrë titullin nga kryetari i Komunës së Dibrës së Madhe, Argëtim Fida

Në Dibër të Madhe më datë 11 shtator 2008 u mbajt ceremonia solemne e shpalljes së Nikolas Knauf, Qytetar Nderi i Dibrës së Madhe. Në këtë solemnitet morën pjesë përfaqësues të pushtetit vendor, Nikolas Knauf më bashkëshorten dhe bashkëpunëtorët Grunke, Dovolani dhe Dellovski, Ali Ahmeti, lideri i BDI-së, gjenerali Gëzim Ostreni, sekretar i përgjithshëm i BDI-së, Fatmir Besimi, ministër i ekonomisë, deputetja Julieta Marku, kryetari i komunës së Zajazit, Ruzhdi Lata, myftiu u Dibrës dhe Bllagoja Spirovski, përfaqësues i Kishës orthodokse, këshilltarë, udhëheqës të institucioneve, biznesmenë dhe përfaqësues nga diaspora.

Nizamedin Papraniku, kryesues i Këshillit të Komunës, në fjalën e tij theksoi se Argëtim Fida, kryetar i komunës ngriti nismën, ndërsa Këshilli i Komunës në seancën e 20-të më datë 2 nëntor, unanimisht mori vendimin që Nikola Ëilhelm Knauf, të shpallet Qytetar Nderi i Komunës së Dibrës së Madhe.

Argëtim Fida, kryetar i komunës, duke përshëndetur të pranishmit, shtoi se: "Nikolas Knauf është themelues dhe bashkëpronar i grupacionit të madh ndërkombëtar Knauf, i cili në 40 shtete të botës ka 150 fabrika ku janë punësuar 20 mijë punëtorë dhe ka një xhiro vjetore prej 7 miliardë dollarë.

Në argumetim të këtij akti solemn, ai u shpreh se, "Para 12 vitesh kur ekonomia e Maqedonisë ndodhej në kolaps, kur kishin falimentuar gati tërë kompanitë, kur Maqedonia sapo kishte fituar pavarësinë, kur Ballkani vlonte si bure baroti ku edhe ndodhën disa luftëra, kur Dibra e Madhe ishte harruar nga ish-sistemi, qytet me infrastrukturë rrugore tejet të keqe, ku në dy krahët kishte rrugë të gjera vetëm 5 metra, zoti Knauf dhe grupacioni i tij vendosën të rrezikojnë e të ndërtojnë në Dibër të Madhe fabrikë gjipsi nga më modernet, me të vetmen arsye se këtu gjenden pasuri të pashtershme mi në Maqedoni . Edhe kur në vitin 2000 në Maqedoni bëhej luftë, UÇK dhe Ali Ahmeti dhanë garanci se asnjë vidhë nuk do t'i dëmtohet kësaj fabrike të Knaufit, gjë që qytetarët dibranë e respektuan maksimalisht".

"Ndërtimi i Rrugës së Arbërit dhe Knauf si strumbullar i ekonomisë, do të sjellin mundësi të mëdha zhvillimi në Dibër të Madhe, Maqedoni dhe Ballkan. Knauf ndihmon financiarisht pushtetin vendor në ndërtimin e infrastrukturës, rezervuarit të ri të ujit, OJQ-të nëpërmjet projekteve, nxënësit, aktivitetet sportive, kulturore dhe rastet sociale", tha Fida.

NIKOLAS KNAUF: "Kur erdhëm fillimisht në Dibër të Madhe ishin ditë të vështira. Tani kemi ndërtuar një fabrikë në zemër të Evropës Juglindore. Korridori veri-jug dhe ndërtimi i Rrugës së Arbërit hapin perspektiva më të mëdha për prodhimet tona në Shqipëri e në Ballkan, duke përfshirë Bullgarinë dhe Turqinë.

gjipsi. Ndërtimi i fabrikës solli edhe kulturën ndaj punës që shërben si shembull edhe për bizneset tjera. Privatizimi i ish fabrikës Radika nga ana e Knauf llogaritet më i suksesshëm.

Nikolas Knauf, duke u falenderuar për këtë eveniment, u shpreh se: "Ndjehem krenar dhe i gëzuar që jam shpallur Qytetar Nderi i Dibrës së madhe. Falenderoj përzemërsisht kryetarin Argëtim Fida dhe tërë dibranët për këtë nder që më bënë. Kur erdhëm fillimisht në Dibër të Madhe ishin ditë të vështira. Tani kemi ndërtuar një fabrikë në zemër të Evropës Juglindore. Korridori veri-jug, dhe ndërtimi i Rrugës së Arbërit hapin perspektiva më të mëdha për plasmanin e prodhimeve tona në Shqipëri, vendet e Ballkanit duke përfshirë Bullgarinë dhe Turqinë. Falenderoj punëtorët, udhëheqësit e fabrikës dhe sektorin e shitjes së prodhimeve tona. Kemi marrëdhënie shumë të mira me pushtetin vendor dhe atë qëndror, që janë garancë për sukseset tona, tha Nikolas Knauf.

Në takimin që Nikolas Knauf me bashkëpunëtorët e tij pati në kabinetin e kryetarit të komunës, ku ishin të pranishëm edhe Ali Ahmeti, Gëzim Ostreni dhe ministri i ekonomisë Fatmir Besimi, Nikolas Knauf kërkoi që sa më shpejt kësaj kompanie t'i jepen lejet e kërkuara për koncesionet për shfrytëzimin dhe rritjen e prodhimit.

Ndërsa Argëtim Fida, Ali Ahmeti dhe Fatmir Besimi shprehën gatishmërinë dhe angazhimin e tyre për të krijuar kushte sa më të mira për veprimtarinë e kësaj kompanie të suksesshme.

Në këtë solemnitet Jeta Mehmeti në flautë dhe Ermal Mehmeti në violinë, interpretuan pjesë të zgjedhura të muzikës së komponuar shqiptare.

Rexhep TORTE

Me bashkëpunim drejt sukseseve

Dibër e Madhe bashkon liderët politikë

Të mërkurën, më datë 27 gusht 2008, Dibrën e Madhe e vizituan Ali Ahmeti, kryetar i BDI-së me ministrat dhe bashkëpunëtorët e tij, Bajram Rexhepi, kryetar i bashkisë së Mitrovicës së Kosovës, të cilët i priti Argëtim Fida, kryetar i komunës së Dibrës së madhe me bashkëpunëtorët e tij.

Në takimin që patën me përfaqësuesit e mediave, Argëtim Fida,duke folur për këtë takim, tha se:" Është nder e kënaqësi që sot në mesin tonë si mysafirë të "Ditët e Kulturës-Dibra 2008" ndodhen lideri Ali Ahameti dhe Bajram Rexhepi, kryebashkiaku i Mitrovicës nga Republika e Kosovës, dhe të ftuar tjerë. Mysafirët i informova për ndërtimet infrastrukturore në qytet dhe për punët që na presin në të ardhmen".

Ali Ahmeti, shtoi se: "zoti Fida më informoi lidhur me ritmin e punimeve në godinën e re të komunës. Dëshira ime është që ajo të kryhet sa më shpejt dhe administrata komunale dhe njësitë rajonale të fillojnë aktivitetet në kushte më të mira, sepse u bë kohë e gjatë që po punojnë në kushte të vështira. Punët duhet të përshpejtohen. Unë do të përpiqem dhe do të angazhohem që organet ekzekutive të qeverisë të ndihmojnë në përfundimin e punimeve edhe me fonde shtesë.

Pyetjes për njohjen e Pavarësisë së Kosovës nga Maqedonia, Ali Ahmeti, iu përgjegj se: "komisionet për demarkacionin e kufirit kanë filluar punën, pasaportat e Republikës së Kosovës tashmë njihen nga Maqedonia dhe jemi shumë afër kur Maqedonia do ta njohw Republikën e Kosovës. Bëhet fjalë për çështje teknike, që nuk kanë dimension politik".

Lidhur me liberalizimin e vizave mes Shqipërisë dhe Maqedonisë, ai u shpreh se: "Parlamenti i Maqedonisë e ratifikoi marrëveshjen për liberalizimin e vizave me Shqipërinë, këtë gjë duhet ta bëjë edhe Parlamenti i Shqipërisë, dhe kjo u takon komisioneve të punëve të jashtme të dy vendeve".

Pyetjes se sa është e kënaqur BDI me koalicionin me VMRO dhe me postet që i mori, ai deklaroi se: "është një fillim i mirë, shpresoj se deri në fund do të kemi përfaqësim edhe më të mirë. Të dyja palët jemi duke i kryer obligimet me përgjegjësi. Jam i kënaqur me dikasteret që i kemi marrë. Dibra do ta provojë angazhimin dhe sinqeritetin tonë dhe ndihma jona ndaj Dibrës do të vazhdojë".

Bajram Rexhepi, i pyetur për sfidat dhe shpresat e qytetit të Mitrovicës, tha se: "Mitrovica ka shumë sfida, por ka edhe shpresa reale. Kosova është unike në territorin e vet të njohur ndërkombëtarisht. Ka probleme teknike në terren, por këto gradualisht do të tejkalohen dhe Kosova do të jetë e tërë", tha Bajram Rexhepi.

R.TORTE

DIBËR, MISTRI PA KOKRRA

Fermerët kërkojnë dëmshpërblim financiar

Fenomeni i misrit pa kokrra ka prekur edhe fshatrat e Dibrës. Dhjetra komuna të rrethit të Dibrës kanë mbjellë me këtë farë misri pa e ditur se si ishte. Fermeret shpresonin që këtë vit, meqë më në fund është zgjidhur problemi i ujit për vaditje në shumicën e komunave, do te kishin prodhim të bollshëm. Të gjithë parcelat e mbjella me misër pa kokrra ka bërë që fermerët të vënë alarmin pasi dimri në këto zona është i egër dhe i gjatë, e keshtu qe blegtoria është në krizë për ushqimin dimëror. Fermerët e Peshkopisë, Burrelit, Bulqizes dhe Klosit kanë bërë shpenzime me miliona lekë, pa llogaritur proceset e punës. Ata kërkojne dëmshperblim për dëmin e madh të shkaktuar. Përfaqësues të firmës "Agroblend", e cila shpërndau nëpërmjet rrjetit të saj të shitjeve farën "shterpë" kanë shkuar para pak ditësh në terren dhe së bashku me përfaqësue lokal kanë evidentuar dëmët dhe kanë premtuar shpërblimin në misër kokër, por banorët e kanë kundërshtuar këtë. Disa prej tyre, megjithëse e përdorin misrin për blegtorinë, nuk kanë besim te misri që mund t'u jepet si dëmshpërblim. "Ata na shitën farën e skaduar. Kush na garanton ne se edhe misri kokërr nuk është OMGJ, për të cilën ne po punojmë cdo ditë për të mos e futur në shtëpitë tonë. Ne kërkojmë suksesin tek produktet bio, ndaj edhe misrin e duam të tillë". Gjithashtu, përfaqësuesit e "Agroblend" kanë kërkuar edhe faturat e blerjes, por fermerët janë përgjigjur se nuk kanë marrë fatura blerje, duke shënuar kështu një skandal tjetër të firmës, shitjen e misrit farë pa faturai "Kopjet e faturave i ka firma" - kanë vënë në dukje fshatarë, duke vënë në dukje se janë të gatshëm të bëjnë denoncimet për këto raste në organet tatimore. Burime zyrtare pohojnë se këtij problemi nuk i është dhënë akoma zgjidhje. Disa punonjës të Ministrisë së Bujqësisë në këtë rreth, në takim me përfaqësues të firmës, kanë mbrojtur anën e fermerëve, por pa gjetur zgjidhjen.

(Korresp. "Rruga e Arberit")

LAJMËRIM

Në kujtim të 32 dibranëve të zhdukur në ujërat e Otrantos në natën e 9 marsit 1996, po përgatitet një një libër. Ftojmë të gjithë familjarët, të afërmit dhe të tjerë që kanë dijeni për këtë ngjarje të përcjellin në adresën e gazetës "Rruga e Arbrit", fotografi, shënime për jetën e personave, dokumente, kujtime, etj. Le të jetë ky libër një lapidar për ta.

Adresa: "Botimet "m&b", Rr. "Zenel Baboçi", Pall. "Ferar", Tiranë. (Për gazetën "Rruga e Arbërit") .

E-mail: **rrugaearberit@gmail.com**

Shkrimtari modern Ramiz Gjini dhe poeti Mhill Velaj midis miqve të librit dhe dashamirësve të shumtë të krijimtarisë së tyre, paraqesin ne New York botimet e tyre të fundit, përkatësisht në prozë dhe poezi

Në New York lexohet shqip!

Libri i fundit me tregime "Rrëfime në hije" është pjesa më e arrirë e këtij shkrimtari dhe tregimi "Frika" konkuron dhe zë vend nderi në letërsinë europiane dhe më tej. T regimi "Frika" është një perlë e rrallë e krijuar dhe e nxjerrë nga thellësia e një shpirti të madh!

Nga **KËZE (KOZETA) ZYLO**

Kolegji amerikan Monroe i New Yorkut gumëzhiti nga gjuha shqipe për orë të tëra në një ditë të shtunë, në një ditë promovimi librash të rinj nga shkrimtarë shqiptarë.

Edhe pse jashtë vetëtinte e bubullonte dhe shiu binte si me shtëmba nga çatitet e bronxit, brenda auditorit ndjeje një puhizë pranverore, që ta flladiste shpirtin me poezitë e Velajt dhe tregimet moderne të Gjinit.

Një nga auditorët e Kolegjit kishte hapur zemrën duke mirëpritur miqtë e shumte të librit shqip, e në këtë rast të shkrimtarit Ramiz Gjinit dhe poetit Mhill Velajt.

Mysafirët kishin zënë vendet dhe prisnin duke shikuar në ekran foto të ndryshme kuptimplotë nga Velaj dhe Gjini, çka tregonte për një mirëorganizim të këtij promovimi dhe dashuri të pakufishme për librin.

Moderatori i këtij promovimi ishte z.Shkumbin Tetaj, i cili me profesionalizem dhe me një kujdes të veçante solli me elegancë dhe kulturë gjithë punën e vyer të dy shkrimtarëve për dekada të tëra.

Librin shqiptari nuk e ka ndarë kurrë nga dora, por nuk e di se ç'kam një ndjesi: që këtu në emigracion merr me shumë kuptim, më shumë dashuri, më shumë vlerë!

Ndoshta ndjej që është i vetmi mik që na bashkon si një urë lidhëse me Mëmëdheun tonë të shumëvuajtur, është i vetmi dashnor që nuk na tradhëton kurrë, ndoshta!

Duke shkruajtur këto rreshta në mendje më vijnë fjalët e Volterit, shkrimtarit, komedianit dhe enciklopedistit të madh francez (1694-1778) i cili shkruan: "Në jetë kam pasur vetëm një mik të sinqertë, LIBRIN.

E ndërsa shikoja me endje në ekran, copëza nga jeta e të dy shkrimtarëve, mendja ime gjezdiste, treste veshtrimin larg-larg diku, tutje ne horizont, atje ku gjithe mendjet tona shqiptare piketakohen, pavarësisht nga pikëpamjet, pavarësisht nga kundershtitë, ato bashkohen nga e ambla gjuha jone shqipe, që më së shumti dhe cilësisht stampohet në libra. Lum, cila penë e bën këtë, lum kush lexon dhe i çmon librat!

Por më konkretisht në këtë ditë ata që i çmonin dhe i dhuronin librat ishin shkrimtaret, që rreth Gjinit dhe Velaj, anetarë të Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë, ishim mbledhur ne, miqtë dhe lexuesit e shumte të librave të tyre.

"Rrefimet në hije" si skulpturat e Mikelanxhelos

Nga **GJEKË MARINAJ ***

Gëzohem, në kuptimin më të sinqertë të fjalës, që patët mundësinë dhe fatin të gjendeni sot në këtë promovim të librave të poetit Mëhill Velaj dhe shkrimtarit Ramiz Gjini. Me vjen keq, që për arsye objektive, nuk pata mundësi të gjendem sot fizikisht mes jush.

Pjesëmarrja në këtë festë letrare, do të ishte një nder dhe privilegj për mua.

Kam pasë nderin të jem anëtar i shoqatës nën Ramizin, si Kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë dhe nën Mëhillin, si nënkryetar i shoqatës, një detyrë shoqërore kjo që po e kryen me dedikim edhe sot. Por mbi të gjitha kam pasë dhe kam privilegjin e madh ti kem miq të vërtet të dy.

Velaj është kthyer në një figurë që në jetë flet me fjalë edhe të pashkruara. Zemërbardhësia e tij ka vazhduar edhe me sponsorimin e disa librave të kolegëve të tij, përfshi këtu edhe antologjinë e sapo botuar "Zemra Prindërore". Gjithashtu, ai eshte edhe njeri nga sponsorizuesit e librit te Ramizit, qe promovohet sot. Me fjalë të tjera, ai u gëzohet sukseseve të te tjerëve. Ndaj e keni sot duke promovuar së bashku me Gjinin veprat e njeri-tjetrit. Kjo pastërti shpirtërore, kjo dashamirësi njerëzore dhe kjo bujari personale gjendet e shkrirë në formë vargu në të gjitha poezitë e ndjeshme të librit të Velajt që sot kemi në dorë. Velaj është një poet që unë e lexoj me shumë kënaqësi dhe gjithmonë pres të lexoj gjëra të reja prej tij.

Velaj dhe Gjini nuk mund të krahasohen me njëri-tjetrin si autorë. Ja vetëm tri arsye për këtë:

E para është se krijuesit janë si yjet—secili ka bukurinë e vet brenda diferencave ekzistuese në paraqitje dhe në përbërje. Krijuesit nuk duhet të krahasohen me njëri tjetrin, por të shijohen dhe të vlerësohen për atë që na japin në letërsi.

Arsyeja e dytë është se klasifikimi kategorik i krijueseve nuk bëhet kurrë me qëllim të mirë dhe gjithmonë është rezultat ose i ngutjes ose i papërgjegjësisë personale të atij që i bën këto krahasime. Ajo është e pranueshme dhe e ndershme vetëm kur vjen qartë si një opinion personal, pra duke thënë "ky apo ai libër, apo ky apo ai shkrimtar më pëlqen me shumë, është më i përafërt me shijet e mia për letërsinë.

Arsyeja e tretë dhe e fundit është kjo: Edhe sikur ta bëja atë gabim e të tentoja ta krahasoja Ramiz Gjinin me ndonjë shkrimtar tjetër këtu në Amerikë, gabimi im do të ishte i pafalshëm. Sepse në gjykimin tim për letërsinë, asnjë prej nesh nuk mund të krahasohet me Ramiz Gjinin. Tregimet e tij apo "Rrefimet në hije" të tij, parë nga një këndvështrim i veçantë, janë si skulpturat e Mikelanxhelos, në të cilat, të heqësh apo të shtosh qoftë edhe gjënë më të vogël, do të prishësh diçka shumë të madhe. Besoj se do të jeni dakord me opinion tim kur ta lexoni librin.

Me respektin më të lartë dhe me dashamirësinë më të madhe për ju si pjesëmarrës dhe për autorët që ju po promovoni sot,

** Poet. Anëtar i shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë dhe themelues i saj*

THANË NË PROMOVIM:

Dalan Luzaj, poet:

Ramiz Gjini me krijimtarine e tij letrare i ngre Karatin Shoqatës dhe letersisë shqipe. Rruga e tij letrare është pak a shumë si rruga që bën avioni. Ai rendi e rendi në tokë gjersa mori lartesitë. Libri i fundit me tregime: "Rrëfime në hije" është pjesa më e arrirë e këtij shkrimtari dhe tregimi "Frika" konkuron dhe zë vend nderi në letërsinë europiane dhe më tej, tregimi "Frika" është një perlë e rrallë e krijuar dhe e nxjerrë nga thellësia e një shpirti të madh! Ajo pati një lindje të vështirë për t'u bërë zbukurim mbi unazë zengjini.

Librin mund ta gjeni në librari ose mund ta porosisni në nr. tel. (04) 22 33 283. Çmimi: 500 lekë

Pëllumb Kulla, shkrimtar:

Në letërsinë shqiptare kanë ndodhur shumë ndryshime, mund ta quaja një termet, me prurjen e shkrimtarëve të rinj. Ende nuk është shoshitur trashëgimia e realizmit socialist, ende nuk është shoshitur e djeshmja, ka boshllëqe në kritikën letrare, nuk po kuptohet vlera dhe për rrjedhojë antivlera. Gjini është një shkrimtar që meriton një vëmendje të veçantë nga kritika profesioniste. Ai është i edukuar në shkollat më moderne dhe gjithashtu ka një bagazh të pasur jetësor. Ai ka shëtitur si bleta nëpër lulet e pahelmuara dhe ka prodhuar mjaltin e vet. Tregimi i shkurtër është shumë afër poezisë. Tregimi "Frika", "Macja e zeze"... etj., mbeten një pasuri e madhe për letërsinë.

Dalip Greca, kryeredaktor i gazetës Illyria:

Nuk është e lehtë të zbërthesh tregimet e Gjinit, pasi ato kanë kode të veçanta deshifruese. Gjini që herët ka paralajmeruar një stil tjetër krijues, larg letërsisë socialiste. Ai është një mjeshtër i veçantë i artit, dhe shkon atje ku buron arti dhe jo atje ku derdhet.

Ndërsa intelektuali **Ilir Spata** do të emocionontе së tepermi sallën me interpretimin e tij me aq pasion dhe dashuri për librin, ai vazhdimisht ka dalë para publikut në interpretime të ndryshme nga poete shqiptare.

Tashmë edhe komuniteti i Laprakës në Tiranë ka xhaminë e tij, falë kontributit financiar të z. ***MUSA RIÇKU.***

Në foto: Një iftar në xhaminë e Laprakës

SË SHPEJTI...

Kolana "Urtësi dibrane" do të hapet me një botim të Shtëpisë Botuese "m&b", me autor Naim Plakun

>>>

dibra në bibliotekën tuaj...

Binakëzimi i këtyre dy shoqërive tona është një fillim i mbarë i bashkëpunimit që në të ardhmen do të zhvillohet edhe më shumë në frymën e miqësisë dhe vlerave kulturore ".

Ditët e Kulturës "Dibra 2008"

Koncert festiv dibrano - kosovar

Ansambli i këngëve dhe valleve "Rexhep Mitrovica"- Mitrovicë nga Republika e Kosovës dhe SHKA "Haki Stërmilli" nga Dibra e Madhe, më 27 gusht 2008, në kuadër të manifestimit Ditët e Kulturës "Dibra 2008", para publikut dibran shfaqën koncert të përbashkët me këngë e valle popullore.

SHKA "Haki Stërmilli" para publikut u paraqit me grupin e valleve, grupin e rapsodëve me në krye Ibrahim dhe Elmaz Lala, ku spikatej trimëria dhe miqësia kosovare dhe dibrane ndër shekuj.Tablloja koreografike "Dibra Kosovë e vogël dhe Kosova plagë saj".

Ansambli "Rexhep Mitrovica » shpalosi vallet kreshnike rugovase, vallen e Shotës, suitën e valleve kosovare, këngëtaren Vlora Brahimi dhe grupin e rapsodëve kosovarë që enthuziazmuan publikun me këngët e vallet e përkryera. Ky koncert i përbashkët, me koreografinë e qëlluar dhe interpretimin mjeshtëror të këngëve dhe valleve ishte mrekullia e skenës dhe e kënaqësisë për publikun.

Argëtim Fida, kryetar i Komunës së Dibrës së Madhe,duke përshëndetur të pranishit, tha se," ky koncert lindi në frymën e një bashkëpunimi dhe binakëzimi mes dy shoqërive tona kulturore që morën pjesë në festivalin Ynegjyl të Turqisë. Bajram Rexhepi e hapi festivalin në Turqi, ndërsa unë e mbylla. Ky bashkëpunim është rezultat i angazhimit dhe lagpamësisë së kryetarëve të këtyre shoqërive, Selim Beqiri nga Dibra e Madhe dhe Haki Shkreli nga Mitrovica".

Bajram Rexhepi, kryetar i Bashkisë së Mitrovicës, i enthuziazmuar nga ky program, para të pranishëmve, u shpreh se: « Vij në Dibër të Madhe pas shumë e shumë vitesh. Dibra e Madhe në ditët më të vështira i hapi krahët për Kosovën. Ne nuk e harrojmë kurrë atë bujari. Binakëzimi i këtyre dy shoqërive tona është një fillim i mbarë i bashkëpunimit që në të ardhmen do të zhvillohet edhe më shumë në frymën e miqësisë dhe vlerave kulturore ".

Ali Ahmeti, lider i BDI-së, në fjalën e tij tha se: « Këtu në skenë kënga e vallja treguan tërë atë histori. Korreografi i ndjerë Panajot Kanaçi la pas gjenerata kultuvuesish të valleve. Arti ishte ai që na e mbajti shpirtin gjallë, sepse po e vrave shpirtin trupi vdes menjëherë. Artistët, vallja, çiftelia, sharkia, polifonia, dasma, të gjitha na mbajtën gjallë. Këto ishin burrimi i vrullshëm që sot Kosova u bë shtet, që shqiptarët e Maqedonisë ecin drejt barazisë së plotë. Kjo është arritja e madhe që buroi nga skena, që iu shpalos popullit nga arti dhe artistët. Jemi një komb me universitet në Tiranë, Prishtinë dhe Tetovë dhe me një flamur, dhe s'ka si të mos jemi të rreshtuar pranë vendeve të Evropës Perëndimore. Do të vjen koha që mes nesh të mos ketë kufij, sepse ky ka qenë ideali i luftëtarëve tanë, këtë wndërr ne do ta realizojmë me anëtarësimin e Shqipërisë, Kosovës e Maqedonisë në NATO dhe Bashkimin Evropian".

R.TORTE

SHENIM

Po vjen "Oda Dibrane"

Organizatorët e "Odës Dibrane" kanë vendosur që edicioni i 13- i saj të mbahet në fund të tetorit. Festivali organizohet nën kujdesin e Bashkisë së Peshkopisë, Qendrës Kulturore, si dhe me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Në këtë festival marrin pjesë grupe dhe shoqëri kulturore, interpretues të folklorit nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe grupe nga rrethe të ndryshme të vendit.

Që nga edicioni i saj i parë, në vitin 1994, në ndryshim nga veprimtaritë e tjera kulturore që me kalimin e viteve përsosen dhe bëhen më të bukura, me "Odën Dibrane" ka ndodhur e kundërta. Eshtë zbehur dhe është venitur, duke sjellë vit pas viti vlera pak të njohura ose të panjohura fare. Sipas një prej organizatorëve të atyre viteve, puna merrej seriozisht, një staf i përgatitur dhe profesionist merreshin me përzgjedhjen e materialeve dhe grupeve dhe "Oda" kishte madhështinë e vet, ashtu siç i ka hije Dibrës. Por tani nuk ka më përzgjedhje materialesh, nuk kontrollohen materialet e grupeve pjesmarrësve dhe ato grupe folklorike që vijnë, shumë pak prej tyre e marrin seriozisht programin që paraqesin. Tani është kthyer në një rutinë për ta pjesmarrja: një xhiro me daulle dhe culë në bulevard, një koncert 15-20 minutash caktuar për ta, një drekë e varfër kushedi në cilin hotel, për të mos përmendur fishkëllimat në koncert apo zhurmat e spektatorëve pa kulturë. Dhe, natyrisht, fajin për këtë nuk e merr askush, por ... fondet e munguara.

Sipas mendimit tim, që "Oda Dibrane" të ekzistojë dhe të përsoset, asaj i duhen bërë disa ndryshime, si nga përzgjedhja e materialeve, ashtu edhe nga mënyra e organizimit.

E para, organizimi i "Odës Dibrane" duhet të dalë nga korniza institucionale. Jo vetëm Qendra Kulturore dhe Bashkia, por edhe qytetarët dhe organizatat joqeveritare duhet të bëhen pjesë e organizimit.

E dyta, duhet përzgjedhur një staf specialistësh të folklorit që të gjurmojnë dhe të ndjekin vazhdimisht grupet pjesmarrëse në në këtë festival. Në "Odën Dibrane" nuk duhet të vijë as edhe një material që nuk i shkon për shtat "kornizave" artistike të paracaktuara për Odën. Atyre "kornizave" që e kanë bërë të veçantë në krahasim me veprimtaritë kulturore që organizohen në vend. Alegoria dhe satira janë dy shtyllat kryesore të "Odës" dhe asnjë material që nuk vjen mes satirës dhe alegorisë nuk duhet të gjejë vend në festival.

E treta, duhet që sa më parë, donatorë, biznesmenë, organizata joqeveritare apo Ministria e Kulturës duhet të deklarojnë publikish mbështetjen financiare, pa e kushtëzuar këtë "me produktet" që ato ofrojnë falas. Çdo gjë falas është pa cilësi. Nuk mund të quhet sponsorizim "një pjatë me supë" për miqtë nga larg. Sponsorizimet duhet të jenë transparente, të deklaruara para gjithë opinionit. Në faqen e internetit të Ministrisë së Kulturës nuk shkruhet asgjë për "Odën Dibrane", megjithëse nga vlerat që ajo ka sjellë në kulturën shqiptare meriton të vihet në krye të vendit. Edhe shitja e biletave është një sponsorizim. Çmimi i tyre duhet të jetë i konsiderueshem për xhepat e spektatorëve. Nuk duhen lejuar në sallë spektatorë me "fishkëllima" dhe që në jetën e tyre e kanë parë këngën humoristike e vallen satirike vetëm si argëtim në dasmën e "kushëririt".

E katërta, "Oda Dibrane", ashtu siç ka dhe emrin, duhet të bëhet pronë e qytetarëve. Organizatorët duhet ta bëjnë këtë festival objekt debati në këshillin bashkiak dhe në prani të qytetarëve të përkushtuar të Peshkopisë. Në ditët e "Odës Dibrane" nuk duhet mjaftuar vetëm me një "ekspozitë pikture" apo "fotografie". Duhen organizuar edhe panaire të prodhimeve artizanale, punimeve me dorë, madje deri edhe prodhimeve bujqësore e blegtorale. P.sh., bashkëpunimi me Drejtorinë e Bujqësisë dhe Ushqimit, mund të çonte që në të njëjtën javë të organizohej Panairi i të Vjelave, një traditë e mirë që po krijohet në Peshkopi.

Dhe e fundit, për "Odën Dibrane" duhet menduar me dashuri e përkushtim. Ky është edicioni i 13-të dhe që gjërat të shkojnë mirë e më mirë edhe në vitet në vazhdim, nuk duhet më shumë se dashuria për Dibrën. Dhe kjo nuk i mungon asnjeriu, sado pak dashuri të ketë!

BUJAR KAROSHI

AURORA GROUP SH.P.K

PROJEKTIM - ZBATIM

koha kalon, cilësia mbetet

Autostrada Tirane - Durres, Km.9
Tel: +355 48 30 2046
Tel: +355 48 30 2040
www.auroragroup.com.al
e-mail: auroragroup@auroragroup.com.al

"Risku" sh.p.k.

Market "Ken"

Laprakë, Tiranë

Tel: +355 4 22 50 480

Cel. 068 20 36 394

Një bisedë e një dibrani në emigracion: jeta e vështirë e emigrimit dhe përvoja jetësore jashtë Shqipërisë, nga Dibra në Greqi e Amerikë. Një histori e secilit prej nesh...

Dua të shkoj të mbush grushtin me ujë në Gurrën e Ostrenit të Vogël...

AMERIKA ËSHTË PËR AMERIKANËT - Sipas bisedës me Remzi Sulën nga Ostreni i Vogël

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

E gjeta në një shoqëri të gjerë, shoqëri që më vonë do të mësoja se përbëhej nga djem, nipër e stërnipër, shoqëri që kish krahë të hapura që nga bregdeti i Thivës ku i takova, në Kifisia të Athinës e deri në Filadelfia të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Një pemë e madhe e jetës njerëzore të ditëve tona, pemë që për Remzi Sulën i kishte hedhur farat dhe shtrirë rrënjët në Ostren të Vogël të Dibrës, në Patos të Fierit, në Greqi e Amerikë...

E pyes në rutinën e zakonshme të gazetarit që mban një diktofon në dorë:

Si e ke emrin ?

Remzi Sula.

Nga je?

Nga Ostreni o Vogël i Dibrës.

Çfarë mban mend nga Ostreni i Vogël ?

Nga Ostreni i Vogël kam ikur i vogël. Kam mbaruar vetëm shkollën fillore.

Vetëm kaq? Asgjë interesante?

Klima e Ostrenit të Vogël është e mrekullueshme. Burimet, uji i mrekullueshëm. Vendlindja është e dashur, e dhimbshme.

Kur keni qenë në Ostren të Vogël?

Kam vite që nuk kam shkuar. Kam rreth pesëmbëdhjetë vjet që më ka larguar emigracioni.

Si ike në emigracion?

Ika në vitin 1997. Deri në Përmet kam udhëtuar me makina të rastit. Pastaj kalova lumin në këmbë. Në anën tjetër na pritën disa makina greke që na sollën deri në Lamia. Kemi paguar nga 160 mijë dhrahmi për person.

Sa vetë ishit?

Unë? Dy veta, treqind e njëzet mijë.

Me kë ishit?

Me gruan.

Sa vjeç ishte gruaja kur kaloi lumin?

Gruaja në atë kohë ishte pesëdhjetë vjeç.

I rezistoi rrugës?

Isha më i fortë unë dhe e mbaja për krahu. (qesh)

Më the që pastaj u vendose në Kifisia. Si erdhe deri në Athinë?

Erdha se kisha djalin. Ai punonte në një lokal. Atje u vendosa.

Sa vjet ndeje tek djali?

Shtatë vjet.

U more me ndonjë punë?

Punova kohët e fundit. Nuk dija gjuhën dhe nuk më merrnin në punë.

Nuk punove në zanatin e të parëve,në zanatin e gurgdhendësve dhe muratorëve të famshëm të Ostrenit?

Kisha zanatin e të parëve të përforcuar edhe me shkollë.

Çfarë shkolle?

Kisha shkollën e ndërtimit. Kam qenë gjeometër, asistent inxhinier.

Ku keni punuar gjeometër dhe asistent inxhinier?

Kam punuar në Patos. Kam qenë përgjegjës në ndërmarrjen komunale. Kam qenë në urbanistikë në Patos. Kam qenë gjeometër komiteti. Kam qenë me privatizimin e banesave dhe në fund me policinë ndërtimore në prefekturën e Fierit.

Pas shtatë vjetësh në Kifisia ku shkuat?

Mbas shtatë vjetësh ika në Shqipëri. Djali që kisha në Amerikë bëri dokumentet e bashkimit familjar, Në vitin 2005 ika për në Amerikë.

Prej atëherë jeni në Amerikë. Si ju duket Amerika?

Amerika është për amerikanët. Për moshat tona nuk është sepse jemi moshë e madhe dhe jemi mësuar të rrimë me njerëzit dhe një gotë ujë, një kafe ta pimë bashkë. Atje nuk gjen rehatinë e vendit tënd.

Tani keni ardhur nga Amerika...

Nga Filadelfia për t'i parë fëmijët në Athinë, në Kifisia. Kam ardhur me djalin, Afrimin dhe me plakën.

Si u mblodhët këtu në Saranti?

Këtu kam nipin, djalin e vëllait, Edin, i cili punon në këtë lokalin këtu në bregdet. Erdha ta shoh edhe atë e fëmijët, nuk mund të mos vija për ta takuar.

Sot erdhët?

Po, sot.

Rremzi Sula me të birin, Afrimin

Do të ktheheni sot?

Kështu kam ndërmend. Do të iki vonë sepse pasnesër do të nisem për në Shqipëri.

Ku do të ndalosh në Shqipëri?

Në Shqipëri sefte kam ndërmend të ndaloj në Patos se e kam ende shtëpinë atje.

Pastaj?

Pastaj do të iki në Tiranë sepse kam shtëpinë tjetër atje që kam ndërtuar dhe dua atje të jetoj, atje të banoj.

Pastaj?

(Qesh). Dua të shkoj të mbush grushtin me ujë në Gurrën e Ostrenit të Vogël...

* * *

Ndërsa bisedonim erdhi Edi, djali i vëllait të Rremziut, administrator i lokalit dhe na grishi të mblidhemi të gjithë rreth tavolinës në një kënd të restorantit ku sytë t'i merrte pamja e bukur e detit me gjirin dhe plazhin në formë patkoi. Ishte një drekë e ngushtë familjare ku ndodheshin të dy djemtë e Rremziut, njeri që punon në Filadelfia të Amerikës dhe tjetri që punon në Kifisia të Athinës. Ishte edhe e motra që punon e jeton në Athinë. Ishte edhe e shoqja e nipit, Edit, me të dy fëmijët. Një vatër e ngrohtë gjaku që vlonte nga dashuria për njeri tjetrin....

Aty, ndërsa herë - herë trokisnim gotat me birrën e ftohtë, biseda iku larg. Iku në Ostrenin e Vogël për të trokitur në kullën e moçme të Ali Sulës, babait të Rremziut, i njohur për atdhetarizmin dhe për jetën e tij në zgjim të dashurisë për mëmëdheun në trevën e Gollobordës. Diçka më kishte thënë për Ali Sulën e Ostrenit edhe Edi në një bisedë rreth filxhanit të kafesë por ajo që më tregoi Rremziu ishte një fletë e një libri që meriton të shkruhet...

U ndava me Rremziun me premtimin e tij dhe të djalit që një ditë në adresën time elektronike do të më vijnë fletë të kësaj historie...

Treva e Dibrës është e mbushur me histori që flenë në kujtesën e njerëzve, histori që duhen zgjuar...

AUDITIMI - SEMANTIKA DHE ETIMOLOGJIA

Nga **QERAM CIBAKU**

Vijon nga numri i kaluar

Në prizmin teknologjik, sipas "Computer Desctop Encyclopedia", (viti 2005), auditimi merr kuptim tjetër, por ne do të mjaftohemi këtu vetëm me interpretimin mëvetësor të "ekzaminimit të sistemeve, programeve, procedurave të të dhënave dhe administrimit të tyre, me qellim që të përcaktohet eficenca e operacioneve kompjuterike".

Duke rrëmuar në "Fjalorin Enciklopedik Shqiptar" (viti 1985, faqe 525), del në plan të parë perkufizimi nominal i kontrollit shtetror si organ i shtetit të diktaturës së proletariatit dhe perceptsioni arkaik mbi auditimin, (pagëzuar me emrin me bazë sllave "revizion"):"Kontrolli i shtetit në kuptimin e gjërë është ai që ushtrohet në bazë të parimit të centralizmit demokratik nga organet e pushtetit shtetror mbi organet e sistemeve të tjera, nga organet e larta mbi ato te ulëta të të njëjtit sistem si dhe kontrolli i brendshëm që ushtrohet brenda për brenda organeve me forcat e tyre nga lartë-poshtë".

Qasje të nocionit audit në guida profesionale:

Përkufizimi i auditimit mbërrin ne vitin 1973 përmes punimit "Prezantimi i koncepteve bazë te auditimit" nga Komiteti i Koncepteve të Auditimit, pranë Shoqatës së Kontabilistëve Amerikanë (AAA). Ky koncept kulturologjik rrethon gjithë qëllimet dhe proceset e auditimit:

"Auditimi është një proces sistematik i përdorimit dhe i vlerësimit të paanshëm të të dhënave të evidencave për aktet dhe ngjarjet ekonomike, me qëllim:

- vlerësimin e shkallës së përputhjes (ngjashmerive) midis këtyre të dhënave dhe kritereve të vendosura, si dhe
- komunikimin e rezultateve tek përdoruesit e interesuar".

(Burimi: V. M. O'Reilly, M. B. Hirsch, P. L. Defliese, H. R. Jaenicke: "Montgomery's Auditing", USA 1990, botimi 11-të, faqe 4).

Nëse mbështetemi në produktin gjuhësor që shtjell fjalori terminologjik i udhezuesve mbi kontrollin dhe auditimin e brendshem i INTOSAI-t, aty gjemë një semiotike të plotë shteruese mbi kuptimësinë e nocionit të auditimit.

"Auditimi është:

- shqyrtimi i aktiviteteve dhe veprimeve të një institucioni për t'u siguruar që ato janë kryer ose janë duke funksionuar në përputhje me objektivat, buxhetin, rregullat, standartet. Qëllimi i këtij shqyrtimi është të identifikojë në intervale të rregullta devijimet, që mund të kërkojnë veprim korrigjues.
- grumbullimi dhe vlerësimi i evidencave mbi informacionin, për të përcaktuar dhe raportuar mbi shkallën e përputhjes midis informacionit dhe kritereve të përcaktuara.
- objektivi i auditimit të deklarimeve financiare është t'i mundësojë audituesit të japë një opinion nëse deklarimet financiare janë përgatitur në përputhje në të gjitha këndvështrimet materiale, në përputhje me një kuadër të raportimi financiar të identifikuar. Frazat e përdorura për të shprehur opinionin e audituesit janë "jep një vështrim të vërtetë dhe të drejtë" ose "paraqet vërtetësisht në të gjitha këndvështrimet materiale", të cilat janë terma ekujvalente". -(KLSH, Paketë përmbledhëse standartesh dhe udhëzimesh për kontrollin dhe auditimin e brendshëm në sektorin publik", Shtypur nga "Ilar", Tiranë 2004, faqe 144).

I botuar në përmbledhjen "Auditing", (viti 1988, faqe 26) nga Donald H. Taylor dhe G. William Glezen, vlerësimi etyd mbi auditimin bazohet fort mbi informacionin e zotëruar (në sensin e tërësisë dhe pacënueshmërisë së tij) ashtu dhe në vlerësimin e tij gjer në dhënien e konkluzioneve me anën e një raporti të shkruar. Definicioni është ky:"Auditimi përcaktohet si proces sistematik mbi zotërimin dhe vlerësimin objektiv të informacionit në lidhje me deklarimet me veprimet dhe faktet ekonomike, me qëllim që të sigurohet shkalla e vërtetësisë së këtyre deklarimeve në raport me kriteret e vendosura dhe me rezultatet që u janë komunikuar përdoruesve të interesuar për këtë informacion"-(*burim i cituar nga Dh. Nikolla etj "Kontroll-revizioni", Shtëpia botuese e librit shkollor, Tiranë 2003, faqe 15).*

Koncepsionin se thelbi i punës së auditëve bazohet në shërbimet e specializuara për interes të publikutdhe në standarte profesionale e ka mbrojtur fuqishëm Organizates se Qeveritare e Kontabilisteve Amerikanë GAO. "Ajo që e bën të dallueshëm e të shquar auditimin si profesion, -arësyetohet në "Librin e Verdhë" të standarteve, -"është të pranuarit e tij si përgjegjësi ndaj publikut. Kjo përgjegjësi bëhet më kritike, sidomos kur auditohen mjedise qeveritare"-("Standartet e auditimit te GAO-s, Uashington, qershor 2003, faqe 13-14).

Gjenerimi i termave spjegues krahas standarteve profesionale ka kthjelluar esencialisht kuptimin e rolin e fjalëve kyçe. Kështu, nëse i përmbahemi fjalorit terminologjik të standarteve ndërkombëtare të auditimit, të aprovuar nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve në Nju Jork, (IFAC), shënohet ky koment:"Objektivi i auditimit të pasqyrave financiare është t'i japë mundësi audituesit të shprehë një opinion nëse pasqyrat financiare në të gjitha aspektet e tyre materiale, janë përgatitur në përputhje me një kuadër të paracaktuar të raportimit financiar"-(faqe 8 e versionit shqipt te "SNA" sipas IFAC).

Të tërheq vëmendjen deduksioni i bërë publik në librin "A history of auditing", (Londër 2006, faqe 1-2) nga Prof. Derek Matthews, ligjërues i lëndës se Historise së Ekonomisë në Universitetin Cardiff te Mbretërisë së Bashkuar, se si në ditët tona ka një difuzion të teknikave të auditimit dhe një provizionim të këtyre shërbimeve. Matthews shquan se:"auditimi sot është një proces qartësisht shumë kontraversal ndaj punës së kontabilistëve. Kolapsi i Enronit, Worldcom-it, së bashku me audituesin e tyre Arthur Andersen, na bëjnë që të ndriçojmë për këto firma mbi vitet e shkuara të kompanive audituese".

I këtyre gjykimeve është dhe komenti tematik i Institutit Hollandez i Auditwve, NIRVA. Në përcaktimet zyrtare të këtij institucioni, auditimi rrok "gjithë procedurat që zbatohen me qëllim që të ofrojmë një nivel sigurie (me një relativitet të lartë, por jo absolut), në lidhje me paanshmërinë e informacioneve financiare, e shprehur në raportet auditive në terma pozitive si një siguri e arsyeshme"-(Richrlijnen voor de Accountants-controle", Amsterdam, mars 2003, faqe 30).

I skalitur, e dendësisht i përdorur e referuar vijon të jetë përkufizimi mbi Auditimin e Brendshëm, formuluar nga (IIA), Instituti i Auditëve të Brendshëm Florida. Ndërkombëtarizimi i karakteristikave shprehëse të sensit botëkuptimor, arësyetohet më së miri në referimin tërësor të tij:"Auditimi i brendshëm është veprimtari e pavarur, që jep siguri objektive dhe këshilla për drejtimin, i projektuar për të shtuar vlerën dhe përmirësuar veprimet e subjektit publik. Ai ndihmon subjektin me anë të një mënyre sistematike dhe të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar frytshmërinë e manaxhimit të rriskut, proceset e kontrollit dhe të qeverisjes".

Ne përfundim për të krijuar një binom harmonik veçorish e përbashkësish midis auditimit dhe inspektimit (si teknikë fragmentare e këtij të parit), po japim dhe cilësitë e inspektimit. "Inspektimi është një proces me anë të të cilit individët monitorohen për të pasur qasje në të drejtat ose punët e tyre. Inspektimi, në një formë apo formë tjetër, praktikisht ndërmerret për të gjitha pozitat në qeveri ose biznes".

FUND

arsim

Shkolla "Pedagogjike" ishte shumë e lidhur me qytetin. Shkolla ndikoi shumë në emancipimin e qytetit, por edhe qyteti e mbështeti shumë shkollën në rrugën e saj të dijes dhe të kulturës.

Shkollat e para shqipe në Dibër

Nga XHEMAL DOMI

Në prill të vitit 1914 Haki Sharofi hapi të parën shkollë shtetërore në Peshkopi. Vetëm një ditë më vonë, më 15 prill Hafuz Ajdini hapi në Trojak shkollën për gjithë krahinën e Ujë e mujës. Ramiz Qatja po më 15 prill hapi shkollën shtetërore shqipe në Trebisht.

Pas shpalljes pavarsisë në vitin 1912 qever ia e kryesuar nga Ismail Qemali shpalli dhe programin e saj për arsimin kombëtar. Sipas vendimit të qeverisë së atëhershme u hapën shkollat normale pregaditore në të gjitha prefekturat. Shkolla normale e Elbasanit hapi dhe kurse të shpejta për pregaditjen e mësuesve të ardhshëm. Nga këto kurse dolën dhe mësuesit e parë dibranë si Haki Sharofi, Hafuz Fetah Ajdini dhe Ramiz Qatja që të tre nga Dibra e Madhe. Ishte kursi i parë që zhvillohej ku u kategorizuan që të tre të aftë për të dhënë mësim në shkollat që do të hapeshin në Dibër.

Vitet rrodhën e kjo qeveri nuk e pati fatin ta kurorizonte me sukses programin e saj afat gjatë në fushën e arsimit. Qeveria e Vlorës dha dorëheqjen duke ia dorzuar pushtetin Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit ku programi për arsimin e popullit shqiptar filloi të ndiqej me përparsi. Në vitin 1914 sapo mbaruan kursin pregaditor të tre dibranët i caktuan në Dibër nga që ishin që të tre dibranë. Haki Sharofi u caktua mësues në Peshkopi, në qendrën e prefekturës së Dibrës. Fetah Ajdini u caktua mësues në shkollën e Trojakut që ishte nën ndikimin e Elez Isufit, ndërsa Ramiz Qatja u caktua mësues në Trebisht të Gollobordës. Në prill të vitit 1914 Haki Sharofi hapi të parën shkollë shtetërore në Peshkopi. Vetëm një ditë më vonë, më 15 prill Hafuz Ajdini hapi në Trojak shkollën për gjithë krahinën e Ujë e mujës. Ramiz Qatja po më 15 prill hapi shkollën shtetërore shqipe në Trebisht. Pra në Dibër pas një sërë luftrash të përgjakshme me pushtuesin serb u hapën shkollat e para shqipe ose siç u quajtën me të drejtë në popull si dallëndyshet e para që sollën pranverën pas një dimri të gjatë dhe të vështirë.

Se në çfarë kushtesh u hapën këto shkolla këtë e tregon Haki Sharofi në kujtimet e tij. "Në varfërinë e madhe dhe privacionet e skajshme të kohës, nxënësit kishin sjellë nga një copë postiqe për t'u ulur dhe nga një arkë dërrase për të vednosur fletoret e shkrimit me ato pak libra e fletore, me një pllakë guri për të shkruar e shlyer herë pas here shkronjat, numrat dhe veprimet me to. Me ato mungesa të shumta mjetesh e orendish, por me shumë dashuri për dijen, mësues e nxënës u futën në rrugën dritës, për mbrothësinë e kombit" Kjo ishte gjendja në shkollën e Peshkopisë ku u ulën 16 nxënës për të nxënë dije dhe dituri. Në Trojak dhe Trebisht gjendja ishte dhe më e rëndë. Kudo vërehej skamja dhe varfëria e tejskajshme, por gëzimi dhe dëshira për të mësuar germat dhe gjuhën e bukur shqipe i tejkalonin vuajtjet dhe mjerimin i cili ishte ulur në vatrat dibrane atëherë. Gëzimi dhe hareja e të vegjëlve lexoheshin qartë në fytyrat e tyre. Si shkolla ngaqë mungonin godinat shtetërore shërbyen shtëpitë e fshatarëve. Ai grusht i vogël nxënësish që u rregjistruan në fillim i vazhduan mësimet gjatë pranverës dhe verës të vitit 1914. Qeveria e princ Vidit nuk pati as kohë, as jetë të gjatë për zbatimin e planeve, të fryra dhe të pa qarta në fushën e arsimit. Në Statutin Organik të Shqipërisë që u nënshkrua në prill 1914 për arsimin parashikohej:

-Liri të mësuarit e ushtruar prej personave me cilësi të kërkuara prej ligjit dhe nën kontrollin e qeverisë.

-Arsimi fillor i detyruar dhe falas për fëmijët shqiptar ku ka shkolla shteti.

-Mësimi i gjuhës shqipe i detyrueshëm në të gjitha shkollat.

-Mirëmbajtja e shkollave shtetërore dhe shkollave të komuniteteve të bëhej prej vetë shtetit.

-Liri e mësimit të fesë në gjuhë të huaj sipas kultit.

Më 2 tetor 1914 u formua e ashtuquajtura "Qeveri e përkohshme e Esat Pashë Toptanit, me qendër në Durrës, që e shtrinte pushtetin e vet në Shqipërinë e mesme. Meqëllim që të zbuste zemërimin e popullit të egërsuar dhe për të kontrolluar veprimtarinë arsimtare në zonën e tij. Esati krijoj drejtorinë e Punëve të Mbrendëshme të qeverisë në gjirin e të cilës ishte krijuar edhe një këshill arsimtar, me të cilin synonte të krijonte pështypjen se ai përkrahte arsimin kombëtar. Në këtë këshill bënin pjesë patriot e atdhetar që nuk lanë rast t'u shpëtonte në drejtimin e arsimit kombëtar. Ata pregaditën dhe botuan më 1915 "Programin analitik të shkollës fillore e të mesme" që është i pari dokument shkollor i kësaj natyre në gjuhën shqipe. Në këtë program del një kompromis konjuktural ku spikasin dy drejtime antagoniste në përmbajtje. Së pari morali fetar dogmatik nga njera anë dhe së dyti njohuritë laike shkencore nga ana tjetër.

Megjithëse ky program sado anemik që ishte nuk mund të realizohej në kushtet e një qeverie antikombëtare siç ishte ajo e Esat Pashës. Në vend vepronin një numër i madh shkollash dhe institucionesh të huaja si greke, italiane, austro-hungareze, sllave, vllahe e fetare me përmbajtje, drejtime e synime të ndryshme aneksioniste, me qëllim të qartë shkombëtarizimin e popullit shqiptar. Në mungesën e një autoriteti shtetëror qendror shqiptar, ata nuk përgjigjeshin askund për veprimtarinë që zhvillonin, kurse për një organizim të rrjetit shkollor shqiptar të njësuar as që bëhej fjalë. Megjithë këto shkollat e para që u hapën në Peshkopi, Trojak dhe Trebisht edhe gjatë viteve 1914-1915 vazhduan të mbijetojnë falë pushtetit lokal dhe vetë popullit arsimdashës dibranë. Këto ishin tre shkollat e para shtetërore në Dibër apo siç i quante populli tre dallëndyshet dibrane.

PERVJETOR

PEDAGOGJIKJA

Nga XHAFER MARTINI

Arsimi në Peshkopi, pas mbarimit të Luftës II Botërore, nisi në institucione arsimore jo të rregullta. Hapja e parë e shkollës shtatëvjeçare, ose unike, si i thonin, u bë më 1945, në një shtëpi dykatëshe në lagjen Dobrovë. Një vit më vonë, në një shtëpi tjetër afër saj, u hap edhe konvikti. Kishte një larmi moshash, pasi, edhe pse shkolla unike ngrihej mbi bazën e shkollës fillore, këtë të fundit mjaft nxënës e kishin kryer disa vjet më parë. Konviktorët vinin nga të gjitha anët e rrethit, nxënësit jokonviktorë vinin nga fshatrat e afërt. Vështirsitë ishin të shumta. Nuk kishte as banka për të gjithë nxënësit, prandaj disa prej tyre rrinin në këmbë. Kur lodheshin, uleshin ata dhe ngriheshin të tjerë. Oborri ishte shumë i vogël, thotë në kujtimet e tij mësuesi veteran M. Dema. Nxënësit vinin rrotull në kohë pushimi duke luajtur me topa leckash, pasi në atë kohë nuk njihej as topi i llastikut. Mbasi vinte mbrëmja, ndiznin fenerët dhe nën dritën e tyre studionin në dhomën ku hanin bukë. Po kështu mungesa të theksuara kishte edhe për bazën mësimore dhe didaktike. Edhe në këto kushte mësimi zhvillohej normalisht nga arsimtarët Edip Tërshana e Hysen Merko. Pas arrestimit të tyre në shkollën unike u dërguan mësues Muharrem Tançi , Islam Vani, Hasan Rrapi, Reshit Kashari e disa të tjerë. Më vonë Edip Tërshanën e pushkatuan. Në ndërtesën që njihet si pedagogjikja e Peshkopisë dhe që është në qendër të qytetit, mësimi ka filluar në vitin 1948 si dhe maturën e parë, ashtu edhe për nxënësit e shkollës së Dobrovës, që u mbartën e u sollën në këtë ndërtesë, ku kishin edhe konviktin. Me konvikt, qysh në fillim, ishte edhe shkolla pedagogjike. Na ra një hije e re kur u bëmë nxënës të pedagogjikes dhe na u hoq togfjalëshi, ata të Shupenzës. Shikonim klasat më të larta, sidomos maturantët, dhe përpiqeshim t'u ngjanim. Atë vit që ne filluam të parën klasë të pedagogjikes, ishin maturantë Xhelil Gjoni, Sejfulla Shehu, Esat Braha, Abdurrahman Tota, G. Kurti dhe shumë të tjerë. Unë me disa prej tyre flija në një fjetore. Në Peshkopi janë ndërtuar mjaft shkolla të reja, madje edhe në vitet e fundit, me projekte të zgjedhura, por asnjë shkollë, si ndërtesë, nuk mund të krahasohet me pedagogjiken e asaj kohe. Ne pedagogjikasve qytetarët na thoshin "studentë" dhe mësuesve tanë "profesorë". E meritonin të dyja palët, nxënës e mësues, ngritjen në rang. Ishim qendra e diturisë dhe e kulturës. Në shkollën pedagogjike të Peshkopisë erdhën nxënës jo vetëm nga fshatrat e rrethit të Dibrës, por edhe nga rrethe të tjera të Shqipërisë, si Tropojë, Kukës, Mat etj. U mblodhën dhe u gërshetuan kulturat, dialektet e nëndialektet, kostumet kombëtare të zonave nga vinin nxënësit, psikologjitë, mënyrat e jetesës.

Shkolla pedagogjike e Peshkopisë u bë shpejt rrezatuese, unifikuese, një qendër e madhe arsimore dhe kulturore, e cila energjitë e mbledhura i çlironte në mënyrë graduale, të përpunuara, të thyera në prizmin e saj kulturor, duke krijuar qysh në fillim një profil të vetin, ku karakteri kombëtar e fryma popullore gërshetoheshin dhe shfaqeshin në mënyrë të natyrshme. Profesorët ishin të rinj entuziastë, të dashuruar pas profesionit të tyre, të gatshëm për të përmbushur me nder dhe krenari misionin e ngarkuar, nxënësit ishin djem dhe vasha të ardhura nga shumë rrethe të vendit, që e zbukuronin edhe fizikisht qytetin e Peshkopisë. Në vendin e hasmërive, të gjakmarrjes, të mbylljes së femrës brenda mureve të shtëpisë, vajzat e ardhura nga çdo skaj i rrethit tonë, por edhe nga rrethe të tjera, ishin një yllësi e re në kostelacionin shpirtëror të popullit të kësaj treve. Dhe ishin vajza të zgjuara, me moral të lartë. Femra nuk mund të fitonte pushtet dhe autoritet me konferenca, me punën formale që bënte kryesia e gruas: ajo autoritetin mund ta fitonte kur të bëhej mjeke, arsimtare, inxhiniere, shkurt kur të aftësohej që shoqëria t'ia kishte nëvojën. Asgjë nuk jepet për mëshirë, gjithçka fitohet me luftë, me dije dhe kulturë, me përpjekje që jo gjithmonë kurorëzohen me sukses... Në atë kohë marrëdhëniet qytet-shkollë nuk ishin si të tanishmet. Jeta kulturore, artistike, sportive e qytetit nuk mund të kuptohej pa jetën kulturore, artistike e sportive të shkollës. Shkolla pedagogjike dhe qyteti kishin të përbashkët ekipet e futbollit, voljebollit, grupet artistike, terrenet sportive, gjithçka. Nuk mund të kuptohej asgjë në atë kohë në qytetin e Peshkopisë pa pjesëmarrjen direkte ose jodirekte të mësuesve dhe të nxënësve të pedagogjikës. Qytetarët vinin në shkollë dhe shkolla ishte në qendër të qytetit. Kuadro drejtues të rrethit, si sekretari i parë i partisë, Jashar Menzelxhiu, kryetari i komitetit ekzekutiv, Rexhep Doda vinin shpesh në shkollë, madje merrnin pjesë edhe në mbrëmjet e dëfrimit. Me pak fjalë shkolla ishte shume e lidhur me qytetin. Nuk ishte vetëm fizikisht pjesë e tij, por kishte midis tyre një lidhje të brendshme, organike. Shkolla ndikoi shumë në emancipimin e qytetit, por edhe qyteti e mbështeti shumë shkollën në rrugën e saj të dijes dhe të kulturës. Qytetarët e Peshkopisë shikonin tek vashat e reja malësore të ardhmen e vajzave të tyre...Qyteti i Peshkopisë i asaj kohe ishte mbartësi i një kulture të lashtë qytetare, të formuar në një truall të përbashkët me Dibrën e Madhe, ku lidhjet e gjakut, lidhjet historike, atdhetare, kulturore nuk u ndërprenë. Ishte ende gjallë frymëzimi atdhetar e kulturor i Iljaz Pashë Qokut, Said Najdenit, Josif Bagerit, Haki Sharofit, Vehbi Dibrës etj. Kishte vuajtur Dibra historikisht për shkollë dhe kulturë në gjuhën shqipe, tani që i kishte të dyja, ajo i donte dhe respektonte. Ne, ndonëse jo të ndërgjegjshëm deri në fund, e kuptonim rolin tonë dhe përpiqeshim të justifikonim ndjenjën atdhetare dhe kulturore të një qyteti me tradita të hershme në këtë fushë. Shkolla pedagogjike e Peshkopisë ishte simbol i qytetërimit. Ishte një çlirim energjish, një kohë idealiste, jo e largët nga Lufta e Dytë Botërore që u bë në emër të këtyre idealeve. Ende nuk ishte venitur shpresa, ajo lulëzonte dhe ne ishim e ardhmja jo në kuptim thjeshtë si brez me ndryshime të mëdha. Dhe ndryshime sollëm, madje shumë të mëdha; zhvilluam arsimin dhe kulturën, përhapëm dritën dhe përparimin, i hapëm sytë popullit.



Kopertina e librit "Pedagogjikasit", e cila sapo u botua nga Xhafer Martini në kuadër të 60-vjetorit të hapjes së shkollës Pedagogjike

Në kuadrin e 95-vjetorit të masakrave serbe në Dibër, historiani Moisi Murra na sjell një histori të shkurtër e të dokumentuar, për të na rikujtuar se historia nuk mund të harrohet pavarësisht politikave globalizuese, të mirëkuptimit dhe paqes

KRYENGRITJA e shtatorit 1913 në Dibër

Nga **MOISI MURRA**

Pas luftës së Kolesjanit, 14-17 nëntor 1912, kryengritjes së Grykës Vogël, 25 dhjetor 1912-11 janar 1913, ushtritë serbe e saktësisht Divizioni I Shumandis dhe Divizioni II i Moravës sulmuan dhe pushtuan gjithë trevën e Dibrës duke krijuar një gjendje tejet të rëndë ekonomike, politike e ushtarake.

Beogradi shovinist nuk u kënaq as nga vendimi i Konferencës së Ambasadorëve të Londrës, të 22 marsit 1913, që e linte Dibrën e Madhe dhe, më gjerë, gjithë trojet shqiptare në Maqedoninë Perëndimore, Kosovën dhe viset shqiptare në Mal të Zi, jashtë kufijve të Shqipërisë së pavarur. Gelinek, atashe ushtarak i Austrisë në Beograd, i raportonte shefit të shtabit të përgjithshëm të tij, më 22 shtator 1913 se: "Dr. Spalajkoviç (zv. ministër i punëve të jashtme të Serbisë në atë kohë) ka deklaruar hapur se "kufijtë e caktuar nga Konferenca e Londrës nuk mund t'i pranojë kurrë Serbia" [1]. "Në kundërshtim me vendimet e Ambasadorëve në Londër, vazhdon Gelineku, Serbia vazhdon të mbajë akoma garnizone në territorin e Shqipërisë autonome... që këto garnizone mbërrijnë deri në Drinin e Zi, kjo gjë provohet zyrtarisht" [2].

Gelinek nuk kishte informata të gabuara. Garnizonet serbe ishin të përqëndruara pothuajse në të gjithë Dibrën, në të dy anët e Drinit të Zi. Në lindje: Lugjaj, Shkeka e Shumbatit, Ostush, Pasmar, Gjarajo, Kodër Kabe, Llasen, Qenok, Popinar, Kodra Pianecit, Dibër e Madhe; në perëndim të Drinit ishin dislokuar: në Prat të Selishtës, Kepi i Gjuras, Kulla e Shalës (Bulqizë), Zerqan, Çerenec, Shkëmbi i Vrabiçit (mbi urën e Spiles), Trebisht, Ostren i Madh, Studën, duke pretenduar për një "kufi strategjik" që rrokte gjithë Dibrën: Lan-Lurë, Qafë-Murrë, Qafë-Buall, Qafë-Studën.

Pushtimi i Dibrës shoqërohej me masakra me të vërtetë të përbindshme: therje, mbyetje, djegie, vedhje. Kudo mbretëronte pasiguria dhe tmerri i masakrave. "Sjellja e serbëve në krahinën e Dibrës u bë e keqe" [3] shkruante ato ditë publicistja angleze Edit Durham. Burrat i kalon në thikë, gratë i mbytnin në lumë, fëmijët i digjnin të gjallë në zjarr, bagëtitë dëmtoheshin, rrëmbëheshin e i nisnin për në thellësi të Serbisë.

"Qeveria serbe i shtrëngoi kaq keq e i bëri aq të liga, - deklaronte Ismail Qemali – sa nga dëshpërimi burra e gra kërkonin vdekjen si të vetmin shpëtim ndaj ç'nderimit, rrëmbimit e vrasjeve" [4].

Kjo gjendje si dhe aneksimi i Dibrës Serbisë, nuk kishte si të mos prodhonte tension tek dibranët, që historikisht ishin vetëqeverisur sipas kanunit të maleve.

Stërmilli na thotë se: "nisi rishtaz me u ba një marrëveshje e fillueme ma parë për një kryengritje kundra armikut" [5]. Bile ai shkon më tej, "në një marrëveshje ndërkrahinore" [6]. Por edhe gazeta "Liria e Shqipërisë" në vjeshtën e vitin 1913 njoftonte se "ka një marrëveshje të plotë ndërmjet dy Dibrave" [7]. Nga ana tjetër veprimtaria e Elez Isufit për organizimin e kryengritjes çlirimtare në Dibër ishte në harmoni me veprimet që zhvillonin udhëheqësit e kryengritësve të Kosovës: Hasan Prishtina, Bajram Curri, Isa Boletini etj.

Që dibranët të udhëhequr nga Elez Isufi, Mersim Dema, Selman Alia, Sefedin Pustina, ishin vënë në lëvizje për organizimin e një kryengritje të përgjithshme kundër serbe, pranohej edhe nga qarqet politike të Beogradit.

Gazeta "Përlindja e Shqipërisë" organ i qeverisë së përkohshme të Vlorës, një muaj para se të fillonte kryengritja (14 gusht 1913), botonte një lajm mbi takimin e parësisë të krahinave verilindore me Ismail Qemalin në Vlorë "Pardje (12 gusht 1913) erdhën zotërinjtë bajraktarë Elez Isufi nga Dibra, Ramadan Zackoci nga Luma dhe Rexhep Bajraktari i Hasit me shumë veta. Lartësia e tyre kanë ndenjur disa ditë në Tiranë, pastaj vajtën në Durrës dhe s'andejmi këtu (në Vlorë – M. M.). Dje kanë patur një bashkëkuvendim me zotin kryetar të qeverisë (I. Qemalin – M. M.) mbi gjendjen e Malësisë që përfaqësojnë dhe mbi masat që duhen marrë për t'i sunduar ato vise sipas mendimit (kuptohet – vendimit – M. M.) të qeverisë" [8].

Me fjalë të tjera qeveria e Vlorës ishte për çlirimin dhe sundimin e këtyre krahinave, pra për kryengritje. Por në rrethanat që qeveriste kabineti i I. Qemalit, prononcimit publik në përkrahje të kryengritësve do t'i shmangej, jo vetëm se duhet të respektonte vendimet e Konferencës së Londrës për asnjanësi, por, se një konfrontim i ri ndër shtetëror rrezikonte seriozisht qenien e shtetit të ri shqiptar.

Sidoqoftë me kthimin e Elez Isufit nga Vlora, nis përgatitja për një kryengritje të përgjithshme antiserbe në Dibër. Më 24 gusht 1913 inspektori i policisë në Shkup, i raportonte komandës supreme, po këtu, se "Elez Isufi gjindet në Dardhë dhe i fton shqiptarët për kryengritje".

Por, dhe qeveria serbe iu vu incidenteve për të provokuar konflikte ndërshtetërore. Më 2 shtator 1913 ushtria serbe bombardoi dhe dogji qytetin e Dibrës së Madhe [9]. Më 8 shtator 1913 qarqet politike të Beogradit shpallën me bujë aktin e aneksimit të gjysmës së trevës së Dibrës dhënë nga Konferenca e Ambasadorëve të Serbisë. Ndërsa më 10 shtator mbreti i Serbisë, Pjetri i I, miratoi propozimin e ministrit të luftës, Vili Bozhanoviqit për mobilizimin e Divizionit të Moravës të thirrjes I-rë së bashku me dy regjimente, I-rë dhe II-të të zmadhuar të fanterisë që 12 ditë më vonë, më 24 shtator 1913, shtypi jugosllav do të shpallte zyrtarisht mobilizimin e këtij divizioni kundër Shqipërisë [10].

Merrej vesh, dibranët përgatiteshin për çlirim të viseve të pushtuara nga Serbia dhe bashkimin e trojeve të cunguara nga konferenca e Ambasadorëve me Shqipërinë autonome. Ndërsa Beogradi zyrtar përgatitej për revansh shtetëror tej piramidave politike të Konferencës së Londrës. Ushtria serbe në Dibër numëronte 5300 ushtarë të R. 14 të Divizionit II të Moravës. Vetëm në qytetin e Dibrës së Madhe kishte 1500 ushtarë të regjimentit të parë të brigadës së Moravës të përforcuar me 4 bateri të artilerisë malore [11].

Gjithashtu, kufirin me Shqipërinë nga Peshkopia në Pogradec (rreth 150 km) Serbia e siguronte me 12 çeta të regjimentit XIX dhe një divizion malore [12].

Forcat kryengritëse popullore dibrane nuk kishin më shumë se 200-300 vetë për çdo drejtim që më vonë arriti në 3000. Sipas dokumenteve – ditar të komandantit të aradheve serbe në Dibër të Madhe, ushtria serbe goditet më 14 shtator 1913 në afërsi të Podgoricës, më 18 në Sinë dhe më 20 në katundin Arras [13].

Sulmi i rrufeshëm, në një kohë, në disa drejtime, në mot e terren të keq, në orët e para të mëngjesit (4.30-5.30) përbëjnë konceptin bazë të artit taktik të luftës popullore të zbatuar nga Elez Isufi në kryengritjen e shtatorit 1913.

Më 21 shtator 1913 ora 4.30 kishte nisur kryengritja më e madhe dhe më e fuqishme kundër serbëve në Dibër me sulm të organizuar në tre drejtime: Ura e Lushës, Kastriot, Kodra e Kabe, Qenok, Dibër e Madhe, udhëhiqesh nga Elez Isufi, Selman Alia, Halil, Llan e Haxhi Kaloshi. Në drejtimin Dibër e Poshtme, Kala e Dodës, Prizren organizuan sulmin dibran e lumjanë të udhëhequr nga Suf Xhelili, Ramadan Zaskoci e Qazim Lika. Në drejtimin Selisht, Kepi i Gjuras, Homesh, Çerenec, Mali i Vrabiçit, Dibër e Madhe sulmuan kryengritësit të udhëhequr nga Mersim Dema, Dan Daci, Bajram Buci e më pas dhe Hasan Koçi e Ramadan Kanxha. Në orën 8.00 të 21 shtatorit goditet dhe çlirohet Peshkopia. Ushtria serbe nis tërheqjen në drejtim të Dibrës së Madhe, por e informuar se i ishin organizuar prita nga fshatarët përgjatë rrugës, ktheu drejtimin për në Zhirovnicë. Në fshatin Bellovë sulmohet nga banorët vendas duke iu shkatërruar plotësisht dy toga artilerie, kurse në Rabdisht sulmi nga fshatarët që kaq i rreptë saqë nuk mund të quhej më ushtri, por grumbull ushtarësh të shpartalluar. Në ndihmë të forcave serbe vjen aradha e Dibrës së Madhe, por duke hyrë në Melan goditet ashpër nga 400 fshatarë të cilët e detyruan dhe këtë të merrte udhën e Zhirovnicës.

Ndërkohë drejtimi kryesor, Peshkopi-Dibër e Madhe, që udhëhiqej nga Elez Isufi, duke vazhduar sulmi me atë furi, po i afroheshin qytetit të Dibrës së Madhe. Për të thyer sulmin e kryengritësve dibranë ose të paktën për të penguar përparimin e mëtejshëm të tyre, komanda serbe kishte vendosur gjatshtë bateri artilerie në Elsë me topa malorë në Kodrën e Pianecit. Në këtë të fundit ushtarët serbë i kishin lidhur me zinxhirë në këmbë, me qëllim që ose të luftonin ose të vdisnin. Për pak çaste situata ndërlikohet, sepse kjo artileri mbante si në dorë gjithë fushën e Dibrës. Por, falë trimërisë, heroizmit, vetëmohimit, zgjuarsisë së Salë Capës më 2-3 dibranë të tjerë që pas njëkrahëmarrje nga lindja e kodrës hidhen mbi pozicionet e zjarrit dhe në luftime të afërt fyt a fyt i asgjësojnë të gjithë topçitë. Një akt heroik ky që do të përsëritet 7 vjet më pas nga Osman Paci në Shkekë të Shumbatit, në Salbatër të Sule.

Në orën 0.4 të 22 shtatorit 1913, kryengritësit dibranë të ndihmuar dhe nga qytetarët e Dibrës me thirrjen luftarake "a besa-besë-burra të zamë Radikën", sulmuan në të gjithë anët e qytetit.

Komandanti i ardhave serbe në Dibër ka shkruar në ditarin e tij: "Sulmi ishte i furishëm, nga të gjitha anët u përcoll nga ezani i hoxhallarëve që dëgjohej nga të gjitha xhamitë e qytetit të cilët bekonin popullin dhe armën shqiptare. Popullsia e Dibrës nga çdo dritare dhe derë shtinte në ushtrinë serbe... në orën 5.30 minuta filloi tërheqja e ushtrisë serbe nga Dibra me humbje të madhe. Në orën 11.00 (22 shtator 1913) Dibra ra në duar të shqiptarëve" [14].

Udhëheqësit e kryengritjes Elez Isufi, Mersim Dema, Selman Alia, Halil e Haxhi Kaloshi pasi takohen dhe me parësinë e qytetit të Dibrës së Madhe, Shaqir Jegenin, Sefedin Pustinën, Qamil Dacin etj., ngritën spitalin për të plagosurit dibranë, por dhe për të plagosurit serb; pastaj ngritën flamurin shqiptar në Dibrën e çlirueme dhe qeverinë e përkohshme me kryetar Sefedin Pustinën [15].

Pas çlirimit të Dibrës, kryengritësit e vazhduan mësymjen në tri drejtime në thellësi të viseve shqiptare. Krahu i djathtë i sulmit që udhëhiqej nga Mersim Dema, Dan Cami, Bajram Buci etj., duke ndjekur ushtrinë serbe u ndeshën me ta tek "Hani i Trebishtit", ku pas një farë qëndrese shpërthejnë mbrojtjen dhe vazhdojnë sulmin drejtë Strugës. Më 26 shtator 1913 kryengritësit hynë në Strugë. Me kryengritësit u bashkuan dhe 60-70 struganë të udhëhequr nga Abdulla Gojdrini, Demir Lena, Riza Hajro etj., të dy palët vazhdojnë sulmin në drejtim të Resnës. Pas luftimeve të ashpra në Bukovë, Straçkë, Petrinë, Stokë, ushtria serbe u tërhoq në anë të Resnjës me humbje të mëdha.

Luftime të ashpra, në përdorim dhe të artilerisë nga ana e serbëve, u zhvilluan dhe në drejtimin Zhirovnicë, Kosovrast, Mavrovë, Vllajnicë, Gostivar. Në hapësirën hanet e Mavrovës – Vllajnicë gjatë gjithë ditës së 25 shtatorit 1913 luftimet nuk pushuan. Në mbrojtje të Vllajnicës dhe në sulm për çlirimin e Gostivarit dhanë jetën 21 dibranë që edhe sot e kësaj dite i kanë varret në Vllajnicë.

Më 26 shtator 1913 kryengritësit dibranë marrin Mavrovën dhe më 27 hynë në Gostivar [16].

Një krah tjetër i kryengritësve i udhëhequr nga Kurt Hoxha, Halil Kaloshi e Maliq Kërçishta zhvillonte luftime në drejtim të fshatrave Koçisht, Koxhaxhik, Mali Stugovë, fshati Garl-Kërçovë. Gjatë luftimeve, me kryengritësit u bashkuan dhe fshatarët e Gorancës, Ballancës, Bareshit, Koçishtës, Koxhaxhikut dhe Broshnicës. Sipas pohimeve serbe, në këto luftime ushtria serbe pati 9 të vrarë e 12 të plagosur [17].

Luftime të suksesshme zhvilluan dhe forcat e përbashkëta dibrane e lumjane të udhëhequra nga Suf Xhelili, Islam Spahia, Ramada Zaskoci e Qazim Lika në drejtimin Shishtavec, në lindje të Gjallicës, Novoselë, Zapod, rrëzë malit të Koritnikut, Dragash, Brat e Zhur.

Më 27 shtator 1913 forcat kryengritëse dibrane të ndihmuara dhe nga banorët vendas zhvillonin luftime në vijën: malet e Mavrovës, dhe para qytetit të Prizrenit tek kroi i Mbretit në Bistër.

Këtij heroizmi atdhetar populli i këndoi:

"... Komandar, or, i biri i shkinës
S'i ke njoftë ti djemtë e Dibrës,
Djemtë e Dibrës e zogjtë e malit
Që ta plasin kapakun e ballit" [18]

Por, dhe shtypi shqiptar dhe ai i huaj jo vetëm ngritën lart heroikën e atyre ditëve, por i treguan diplomacisë evropiane se shqiptarët jo vetëm janë autoktonë në trojet e veta dhe kombi më i vjetër në Ballkan, por janë në gjendje t'i mbrojnë këto troje dhe me gjak.

Gazeta "Ozor" e Zagrebit publikonte 1000 të vrarë serbë, 300 robër dhe shumë materiale luftarake [19]. Por dhe nga dibranët dhanë jetën 63 kryengritës.

Kryengritësit dibranë që më 23 shtator nëpërmjet Aqif Pashë Elbasanit i kërkuan qeverisë së Vlorës armë e municion. Dhe Aqif Pasha i shkruante kabinetit të I. Qemalit: "Në rast se bie Dibra përsëri në duar të armikut, kjo do rrjedhë vetëm nga mungesa e municionit dhe e armëve" [20].

Më 1 tetor 1913 nis kundërmësymja serbe në shkallë të gjerë. Në radhët e kësaj ushtrie të pompuar me cinizëm për ekspansionizëm e hegjemonizëm shtetëror, numëroheshin rreth 40.000 ushtarë.

Forcat kryengritëse dibrane, rreth 3000 vetë pa armatim, pa municion, pa ushqim e veshmbathje e pse jo dhe pa mbështetje në plan të brendshëm dhe atë të jashtëm, po shkruanin aktin e fundit të heroikës së madhe të vitit 1913.

Ata pasi interceptuan me heroizëm ushtrinë serbe në malet e Petrinos, Jamës, Vllajnicës, Prizrenit, organizuan tërheqjen me luftim duke ju dhënë mundësi pleqve, grave e fëmijëve të largohen në thellësi të viseve shqiptare. Ndërsa në Kala të Dodës kryengritësit të udhëhequr nga Suf Xhelili e Qazim Lika e thyen ushtrinë serbe dhe e detyruan të tërhiqet në Bicaj.

Dibra u ripushtua. Fshatrave pothuaj të gjithëve ju vu flaka. E megjithatë, kryengritja e shtatorit 1913, u konsiderua e shuar nga autoritetet serbe në paraditen e 4 tetorit 1913, kur kompania e 12 e këmbësorisë "Car Llazar" e komanduar nga kolonel Milivoje Stojanoviç, dogji kullën e Elez Isufit në Sllovë [21].

Si përfundim mund të themi se, kryengritja e shtatorit 1913 u përgatit, u organizua dhe u drejtua nga udhëheqësit popullorë të Dibrës në ▶

profil

Interviste ekskluzive me yllin e vallëzimit, dibranin Toni Dovolani, në edicioni e 7-të të spektaklit televiziv, "Dancing with the Stars" (Vallëzo me yjet)

Toni Dovolani: **Jam krenar** që po e tregoj veten **se jam shqiptar!**

Jam krenar që po e tregojë veten se jam shqiptar! Jam i Prishtinës, jam i Dibrës, Jam Shqiptar! Ne të gjithë jemi shqiptar të një gjaku dhe të një gjuhë, pavarësisht se ku kemi lërë apo jemi ritur. Ne duhet të ruajmë e të kultivojmë edhe këtu në SHBA-së, kulturën dhe traditën tonë t'i tregojmë botës se jemi shqiptarë. Prej nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Çamëria, Mali i Zi, Presheva, Medvegja, Bujanovci dhe Diaspora. Kudo duhet të tregojmë se jemi shqiptar. Të jemi sa më të bashkuar. Dhe t'a rrisim shqiptarinë edhe këtu në Amerikë.

Nga BEQIR SINA, New York

BROOKLYN NY : Vallëtari dibran Toni Dovolani, njihet nga teleshikuesi shqiptar brenda SHBA-së, në Shqipëri, Kosovë e viset e tjera shqiptare, si pjesemarresi i rregullt i edicioneve të spektaklit garues "Vallëzim me Yjet". Dovolani ka garuar pa shume sukses gjer tani me partnere si Stacey Keibler, Sara Evans, Leeza Gibbons, Jane Seymour dhe në edicionin e 6-të, me komedianen njujorkase Marissa Jaret Winokur. Ndërsa kur filloi edhe edicioni i 7-të i spektaklit "Vallëzimi me Yjet", ai doli në garë me partieren, aktoren e famshme me origjinë italiane, Susan Lucci (Suzan Luçi)

"Vallezimi me Yjet", është një shfaqje spektakel televiziv, i llojit të vetë në SHBA, e cila shfaqet, organizohet dhe transmetohet nga programi shumë i njohur televiziv amerikan ABC, dhe në anglisht quhet "Dancing Ëith The Stars". Në këtë shfaqje merr pjesë, për të shtatën një shqiptar, që amerikanet e thërrasin nga Kosova, i cili quhet Driton "Tony" Dovolani. Pasi ai vetë ka lindur në Kosovë, me prindër babai nga Dibra e Madhe dhe nëna nga Kosova.

Mirëpo, ajo +farë është me rëndësi, në të gjitha revistat e ilustruara, tabloide, e japin këtë ngjarje dhe aty gjithkund në qendër të vëmendjes është edhe Toni. Ato shkruajne se kombësia e tij është Shqiptar (Albania). Gjithashtu, edhe një reviste më prestigjoze në Amerikë e artistëve, People, ka shkruar të njëjtat gjëra dhe ka dhënë një intervistë të tijën. Aty ai shkruante gjerësisht se është nga Kosova dhe se është Shqiptar, pastaj se është i martuar dhe se gruaja e tij quhet Trendafile, nga Dibra e Madhe, pastaj se ka edhe tre femije të cilëve u ka vënë emra shqiptarë. Prej disa vitesh, Toni dëshiron të ndihet i qetë pranë familjes së tij, në vilën më të re në, Stratford.

Në këtë garë të mahnitshme vallëzimi, e cila, sesionin e kalur tërhoqi vetëm në një mbremje deri në 18 milionë teleshikues, vallëzimet më të preferuara janë në disa mënyra, dhe 10- llojeve të kërcimeve si: "Cha Cha - Foxtrot - Jive -Paso Doble - Quickstep - Rumba - Samba - Tango - Viennese Ëaltz - Ëaltz, Vallezim latin, Tango tradicionale sallonesh, Vallezim rutine, Vallëzim popullor. "Vallëzim me yjet" është një serial origjinal në llojin e vet. Çiftet përbëhen nga një person i famshëm dhe balerin profesionist. Çiftet duhet të kërcejnë sipas një stili alla Fred &Ginger.

Ndërsa, edicioni i gjashtë me partneren time Marissa Jaret Winokur, arrita të kem më shumë adhurues sesa kisha arritur gjithsej deri në atë edicion. Kjo për shkak se të gjithë adhuruesit e shumtë të Marissa Jaret Winokur, u bënë "tifozët" e çmendur tanët. Edhe disponimi im me këtë kërcimtare ka qënë shumë më i lart sesa ky kësaj rradhe.

B.S: Toni, dy edicionet e fundit, ju "hoqët dorë nga partenret e reja, dhe keni zgjedhur ato me moshë të madhe dhe me eksperiencë" , Pse ky lloj ndryshimi?

T.D.: (qesh) Mosha në vallëzim nuk të pengon fare. Kemi parë shumë filma të vjetër, kur në mbrëmjet mondane të vallëzimit ata që kërcejnë bukur janë gjithmonë më të vjetërit. Të vjetërit kërcejnë plotë finesë dhe tregojnë më fisnikëri gjatë vallëzimit. Pra, zoti Sina, nga eksperienca vijnë në "dyshme" më shumë lëvizje tërheqëse, të cilat kanë të bëjnë me kohën kur i ke fituar t'i ato mënyra të të kërcyerit. Në vallëzimin që quhet klasik, si për shembull nuk ka asnjë farë ndryshimi në moshë. Kjo ka të bëjë më shumë sesa si t'i vallëtar ose vallëtare e ke ruajtur atë çka ke mësuar ose ke demostruar gjatë kërcimeve, qofshin ato publike apo në mjedise të vogla familjare.

Sidomos, Susan Luçi, pres t'a prezantojë veten shumë bukur. Ajo ka një shkathtësi dhe klasiçizëm të shkëlqyer. Ajo ka 14-vjet që po përgatitet për të dalë në skenë edhe si kërcimtare profesioniste. Mendojë se do të jetë e "pandalshme" në këtë ambicje së bashku me mua, pa dallim se çfarë moshe ka.

B.S: A keni pasur deri tani ndonjë " mosmarrëveshje" me Jurinë? Ose siç i themi ne shqiptarët "t'ua kenë ngrënë hakun"

T.D.: Jo! Ah më kujtohet diçka, para tre edicioneve kemi pasur një "përplasje" të vogël më Jurinë e spektakilit " Vallëzimi me Yjet". Ishte diçka shumë interesante:" Pasi përfundojë konkurimi, bëmë një debat jo të "hijshëm" lidhur me vlerësimin që ata na bënë. Nuk ishim dakort fare me ato pikë që ata na dhanë." Mirëpo, gjithçka është tjekaluar dhe me asnjërin prej anëtarve të Jurisë, nuk kemi mërira. Bile, më pasë, me të gjithë Jurin jemi si shok të mirë.

B.S: Ku e keni "syrin" kësaj rradhe, deri në çfarë vendi do të shkoni?

T.D.: Në këtë edicion me partneren time Suasan Luçi, kam shumë besim se do jemi në krye të garës. Siç ta përmenda edhe më parë, Susan për mua ka një eksperiencë të mirë, dhe ka shumë adhururues të saj të cilët do të votojnë vetëm për ne. Përcjellësit e Susan dhe ata që kam krijuar unë deri tani, patjetër që do të na japin votat vetëm ne.

B.S: Kush të "trembë" më shumë shumë nga çiftet e tjera ?

T.D.: Të them të vërtetën! Lance Bass - Kim Kardashian, të cilët kan qënë dhe pjestarët të grupit të famëshëm amerikan in Sing. Ata janë me miliona adhurues në mbarë SHBA-së, çka i kanë fituar prej kohësh këtë përcjellës të cilët patjetër do të votojnë për ta.

B.S: Në cilin stil mendon se je më i përgatitur dhe më i suksesshëm?

T.D.: Jamë në stilin latin të kërcimit, pasi ky llojë kërcimi ka shumë ngjashmëri për nga dinamika dhe eleganca nga vallëzimi i çifteve shqiptare nëpër ballo. Dhe kam qënë shumë i suksesshëm gjatë vallëzimeve kur në njërën prej sitleve të mija gjatë spektaklit konkurues, vallëzova me veshjen e cila kishte ngjyrat e flamurit shqiptar, kuq e zi dhe në kurriz kisha vendosur një shqiponjë me dy krena,

B.S: Toni, meqenëse përmende ngjyrat tona kombëtare, si ndjehesh përpra shqiptarëve kur vallëzon me emrin Toni Dovolani - shqiptar i Amerikës?

T.D.: Jam krenar që po e tregojë veten se jam shqiptar! Jam i Prishtinës, jam i Dibrës, Jam Shqiptar! Ne të gjithë jemi shqiptar të një gjaku dhe të një gjuhë, pavarësisht se ku kemi lërë apo jemi ritur. Ne duhet të ruajmë e të kultivojmë edhe këtu në SHBA-së, kulturën dhe traditën tonë t'i tregojmë botës se jemi shqiptarë. Prej nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Çamëria, Mali i Zi , Presheva, Medvegja, Bujanovci dhe Diaspora. Kudo duhet të tregojmë se jemi shqiptar.Të jemi sa më të bashkuar. Dhe t'a rrisim shqiptarinë edhe këtu në Amerikë.

Kryengritja e shtatorit dhe masakrat serbe të tetorit 1913 në Dibër

ballin e së cilës shkëlqeu fytyra e veteranit atdhetar Elez Isufit, dhe hedh poshtë pohimet e historiografive serbë se ajo u iniciua dhe u drejtua nga oficerë austriakë e bullgarë.

Së dyti, në këtë kryengritje për herë të parë u organizuan forcat popullore dibrane dhe u vunë nën komandën e shtabeve drejtuese të një komandë të centralizuar.

Së treti, ajo i tregoi diplomacisë evropiane se vendimet e marruna në Konferencën e Ambasadorëve për aneksimin e viseve shqiptare Serbisë, jo vetëm janë një padrejtësi që duhet korrigjuar, por se shqiptarët nuk do të rrijnë duar lidhur sikur të ngelet qoftë edhe një i vetëm.

Së fundi, kryengritja e shtatorit e vitit 1913 edhe pse nuk arriti të ngrihet në nivelin e kërkesave kombëtare, ajo qe pjesë e luftës së popullit shqiptar për çlirimin e viseve të okupuara dhe bashkimin e trojeve të cunguara me Shqipërinë autonome.

1, 2) Arkivi i Vjenës, viti 1913, letër e Gelinekut, dt. 22.9.1913, nr. 4178
3) Edit Durham, "Njëzet vjet ngatërresa ballkanike", Tiranë, 1944, f. 207.
4) Historia e Shqipërisë, Tiranë 1972, f. 173.
5,6) H. Stërmilli "Dibra në prag të historisë" (dorëshkrim) Tiranë, 1940, f. 81
7) Gazeta "Liria e Shqipërisë", gusht 1913
8) Gazeta "Përlindja e Shqipërisë", 14 gusht 1913
9) Arkivi i Vjenës, telegram nr. 4279, 2.9.1913, Von Litkovski Referatit I
10) Gazeta zyrtare "Sepska Norne", dt. 12/25 shtator 1914, nr. 199
11) Halim Purellku, revista "Jehona", 6/1993, Shkup, f. 43
12) Raport i Vicekonsullit Grei; The publik Recordoffice, London, Foreign Office, 424/287, 4496, dok. Nr. 22, Rev. "Jehona", Shkup, 6/1993, f. 112
13,14) Limon Rushiti, "Jehona", Shkup, 6/1993, f. 69.
15) Zekaria Cana, Populli shqiptar në kapërcyell të shek. XIX, prishtinë, 1990, f. 175-176.
16,17) H. Purrelku, vep. e cituar, f. 50.
18) H. Stërmilli, vep. e cituar, f. 84.

Hajri Shehu vjen me nje tregim interesant me temë nga vitet '20, por me një mesazh aktual e shumë domethënës

Tregim nga Hajri SHEHU

Hyzmeqari

Kishte dëgjuar të thoshin se "djali o bahet, o nuk bahet deri në moshën gjashtëmbëdh jetë vjeç". Rasimi e kishte kaluar paksa këtë moshë. Prandaj, kur i tha atë ditë babai se e kishte pajtuar hyzmeqar, e priti me qejf. Nuk mund të rrinte poshtë shokëve, që do të thoshte se edhe ky ishte bërë, se edhe ky nuk ishte i pazoti. Të nesërmen do të nisej hyzmeqar.

Atë natë, darka qe paksa e ndryshme nga darkat e tjera. Nëna kishte pasë ruajtur për mik një dorë petas, dhe i zjeu.

Pasi hëngrën darkën e lanë duart, u ulën mbi hasrat që ishin shtruar për së gjati në të dyja anët e oxhakut. Fëmijët më të vegjël u gëzuan edhe më sepse e ëma u solli nga një grusht lajthi pas darke. Edhe këto i kishte ruajtur. Mblidhnin lajthi në pyll verës, por i shisnin për të blerë me ato para opinga e pëlhurë për këmisha e për çarçafë. Edhe fëmijët mblidhnin lajthi. Madje, edhe kokrra dëllinje. Dikush i blinte edhe kokrrat e dëllinjave. Thoshin se i çonin jashtë vendit, kurse këtu as dhitë nuk i hanin.

Pasi pushuan trokëllimat e gurëve që thyenin lajthitë, babai iu drejtua Rasimit:

- Rasim, ta thashë sot baba një fjalë.

- Po, babë, - ia ktheu me përulësi e nderim Rasimi.

- Do të shkojsh hizmeqar në Valanë. Do të rujsh dhentë e Farisë. (Këndej edhe emrat e burrave që mbarojnë me *i* të theksuar i shquajnë si të ishin të gjinisë femërore). Farinë e njohin krejt. Si të hish në katund, pyet ku e ka shpinë se ta dëftojnë ene cullt e katundit. Vetëm, të lutem baba të më nderojsh: punën ta bajsh tamam, pa garravia, pra mos të të ndigjohet zani i gojës dhe mbaje mend nji gja që baba e ka fort marak: mos ven dorë as edhe mbi nji gjethe hudre! Pastaj, babai i tregoi rrugën: do të kalojsh Gurin e Shqipeve, do të hecish drejt, do të zdripish Gurit të Zi, teposhtë e te nji përrue që quhet Izvir, teposhtë prapë e te Përroi i Mullinit, hec prapë drejt rrugës e duken shpitë. Si t'hish në katund, pyet ku e ka shpinë Faria. Babai tha nja gjashtë fjali, por fshati ishte larg jo më pak se katër orë.

Të nesërmen, Rasimi u ngrit herët. U vesh si përditë. Vetëm opingat e llastikut i kishte të reja. Nortat (gjalmat) ishin ato të vjetrat, por të lara e të bardha si bora në mal. Tashmë, vërtet, u duk burrë se vuri edhe kësulë. Kësula nuk ishte e re, por e pastër. Duket, ishte ruajtur në arkë.

E gjeti shtëpinë. I vunë një stol të vogël – rroke i thoshin - e u ul në kurt a si i thonë ndryshe, oborr. Erdhi i zoti i shtëpisë. Qe burrë i bëshëm e i këndshëm. E pyeti dhe e shiri. E pyeti sidomos për babanë e Rasimit iu bë qejfi. E kuptonte që pyetjet ishin një lloj vlerësimi. I tregoi punët që do të bënte. Kryesorja ishte tufa e dhenve. Rasimi deshi ta pyeste kush ia kishte kullotur deri atë ditë, por diku te pojata i ndeshën sytë në kërrabën e bariut. Kërraba kishte në fund kërlikun – një si grep, me të cilin bariu mund të zinte e të tërhiqte për këmbe çdo dele. Ishte kërraba tip në të gjithë krahinën. E kishte parë edhe në fshatin e tij. Madje, edhe me gdhendje, që do të thoshte se kur delet kullotnin, bariu gërryente a gdhendte me çakí kërrabën, shkopin, shoqëruesin e tij të përhershëm. Kuptohet, gdhendjet ishin sipas intuitës artistike të individit, por, vërtet ishin artistike. Kishte kërraba edhe me iniciale shkronjash! Por, teksa mendonte për këtë, kujtoi menjëherë se tufa e dhenve që do të niste nesër për kullotë e kishte pasur bariun. Pse e kishte lënë tufën, nuk ishte punë e tij; do ta mësonte më vonë ose do t'ia thoshin më vonë.

Fjeti disi mirë? Jo, nuk fjeti. Nuk fjeti se ishte te vatha. Vatha duhej ruajtur, sidoqë kishte dy qen të mëdhenj – një karabash e një karaman, të cilët, për çudi u miqësuan menjëherë me çobanin e ri.

Të nesërmen ishte Shëngjergj, 6 maj – festa e dytë e pranverës, por më e madhe se Ditëverja. Në Shëngjergj, vërtet kishte ardhur vera: mugulli e kullosa i kishin mbuluar pyllin e mezhdat e arave.

Dita e Shëngjergjit ishte shumë e bukur. Atë ditë shkalloheshin në veshë qengjat. Atë ditë, ata ndaheshin nga mëmat e tyre. Krijoheshin kështu dy tufa. Qengjat blegërinin fort. Fort blegërinin edhe mëmat e tyre. Ishte një ndarje, por dhe një simfoni. Në anën tjetër, larg vathës, shtëpia e të zotit të deleve kishte festë. Festë motmoti, - do ta quante një folklorist a etnograf. Kryemotmot e quanin katundarët. Me rite të bukura. Rasimit i dukej, sidomos i bukur riti i luleve përreth mëtinit, tundësit.

Drekëhera qe, gjithashtu shumë e bukur. Delet mërzenin e Rasimi pati rastin të ishte pjesëmarrës në lojërat e djemve. A i bënë favor si për mik, apo ishte më i zoti Rasimi, nuk e dimë, por në lojën brezahipas ai shkëlqeu. Edhe në lojën rrasash. E vunë re me cep të syrit edhe vajzat. Dhe, si më e zoti, Rasimi u ngjit në atë arrën e madhe, shumë lart, deri aty ku kishte një koshtar sorrash, e vuri litarin për shnegull (shilarës), të luanin cucat. Po, cucat. E, cucat ishin si hergjele. I bënte haja? Besoj, i bënte klima, uji, ajri, e puna me shatë. Por, jo më pak "hergjele" ishin në punë të gjergjefit e të kërrabëzave. Qëndismat e fanellat e çorapet me lule njiheshin gjithandej. Se cucat bëheshin nuse e çonin edhe dhanëtitë e tyre.

Rasimit iu dukën vajzat shumë qytetare, sipas shprehjes së tij, "shumë të holla" në atë lojën "Jena na shqiponja". Vetëm po ta shohësh vetë, qoftë edhe të filmuar, bindesh se aty ka, vërtet qytetari. Kështu thonë të gjithë. Janë dy grupe vajzash. Ballë për ballë. Në një largësi rreth njëzet metra. Veshur me petka ngjyra-ngjyra. Si lulet e fushës. Si lulet e malit. Si në një vallëzim modern, në një vijë, me duart në bel të njëra-tjetrës, ato drejtohen për te pritëset (pala tjetër) duke kënduar: *Jena na shqiponja* (dhe refreni). Kthehen gjithë delikatesë në vendin e tyre duke lëvizur praptas – sipas ritmit të këngës. Vjen pala tjetër, me po kaq delikatesë: *Ç'doni ju shqiponja* (dhe refreni)? Niset pala e shqiponjave: *Duem nji ma të bukurën* (dhe refreni). - *Cila asht ma e bukura* (refreni)? - *Ma e bukura asht D.* (refreni). Kënga vijon derisa te pala pritëse nuk mbetet asnjë vajzë sepse të gjitha vajzat janë të bukura e të gjitha bashkohen me shqiponjat. Refreni i bukur e shkuarja e kthimi me delikatesë ballas e bëjnë këngën dhe shfaqjen, vërtet shumë elegante.

Natyrisht, për çdo herë që zgjidhet e bukura, sytë e vajzave shkëlqejnë. Cila do të jetë e bukura më e parë? Po më pas? Cila është preferenca? A ka këtu miqësi e anësi? Besojmë që ka. E, kjo e zbukuron garën, zgjedhjen, shfaqjen. Por, sidoqoftë, të gjitha vajzat janë të bukura e të mira sepse në rreshtin e tyre nuk mbetet asnjë, e kësisoj të gjitha kënaqen.

Po. Por Rasimi kishte ardhur për punë. Dhe për fitesë. Kur të shkonte me leje, duhej të çonte ndonjë lek në shtëpi. Vëllai më i vogël e dy motrat më të vogla do ta shikonin nga xhepat. Leja ishte një natë në muaj. Do të shkonte pasi ta sillte tufën nga kullota e pasi të milej tufa e të futej në vathë a në kotar për fjetje. Do të ngrihej menatë të nesërmen për të ardhur e për ta lëshuar tufën prapë për kullotë.

Puna nuk dukej fort e lehtë. Ishte i madh meraku për punën. E, do ti që megjithatë, qysh ditën e parë i ndodhi një aksident. Vërtet, aksident. Një dele deshi të hynte në një arë të mbjellë. Rasimi i hodhi një plis dheu që ta trembte. Plisi, padashtas e goditi në kokë. Qe i tharë e i fortë si gur. Delja u shtrembërua, u tërmeg e ra përtokë. Ou!, - ia bëri Rasimi. Ou, ç'më gjeti! Ou, cofi delja e huej! Ou, i mjeri unë! Shkoi me vrap në një vijë e mbushi këtulën me ujë e me ngarendas ia hodhi në kokë deles. Qiti pagurin e dhallës nga anxhiku, i hapi gojën dhe i nxori llapën e ia zbrazi tërë dhallën. Delja ... e ngriti kokën! Një mrekulli! U ngrit pak si e trullosur, por nisi t'i ndiqte shoqet. Atë natë Rasimi nuk hëngri darkë. Nuk i hahej. Nga meraku për delen. Nuk e dinte Rasimi: ai kishte fishkëllimën, gjuhën për delet e s'kishte pse përdorte as plisin, as gurin. Sidomos te delet – një kafshë e bekuar nga Zoti. Deles fishkëlleji dhe ajo tërthon rrugë. Delja nuk bën zë edhe kur e shtrin për ta therur. Dhia, po. Dhia tund mëhallën. Dhe, Rasimi e mësoi fishkëllimën fare shpejt: vetëm me buzë e edhe me dy gishta.

Pas disa ditësh dhentë i ngjitën në stan. Me korbulla, sheka, kazana, mjelëse (vedra), batanije, ngarkuar në kuaj. Qentë prinin kopenë. Në bjeshkë kishte ujë të ftohtë. Me pipëz prej kashte thekre mund ta pije se ishte akull i ftohtë e të përcëllonte buzët. Tani me pipëz pihet Ivi, Spraiti, Kola ... Ujqër kishte e jo si miq të paftuar, por si armiq, mu në mes të nëterrësisë, përpiqeshin t'i afroheshin stanit. Por Rasimi dhe karabashi e karamani ishin syhapët. Asnjë dele a qengj s'u varrua. Bulmeti qe bulmet.

Zdirgjja në shtator qe festë. "Ja kalesha që prin! Ja rogusha!" Çobani i mëparshëm e pati vënë pengojsë te këmbët, që të mos ecte fort se rogusha printe gjithnjë e sa ecte ajo, ecte e tërë tufa. Ajo lodhte tufën; lodhte edhe çobanin. Me "ja, ... ja" njerëzit shoqëronin hyrjen e deleve në avlli. Çobani lavdërohej. I takonte, sigurisht.

Rasimi ndenji plot tre vjet hyzmeqar te Faria. Çoi ca pará në shtëpi. Tre vjetët e burrëruan. Ai hidhte shtat vit pas viti. Vetëm rritej. I dolën edhe qimet e fytyrës. Edhe tufa vetëm rritej. U miqësua jo vetëm me familjen e pronarit, por dhe me gjithë katundin. Zor se e dalloje si jabanxhi nga djemtë e katundit. Në shtëpi, bënte edhe punë të tjera. Në dimër, çante dru për zjarr. Shkonte edhe në mulli, sepse delet hanin në grazhd. Grazhdet e deleve i bënte aty nga nëntori. Gratë, kur kishin ndonjë punë si të vështirë, si larje shekash a shkundje qilimash, thërrisnin Rasimin, sepse hyzmeqar do të thoshte më shumë se çoban. Me një fjalë, Rasimi mbante shtëpinë e Farisë.

Ishte fillimi i marsit. Ftohtë ishte ende. Faria, i zoti i shtëpisë, mori një gacë të ndizte çibukun. Si i zbehtë ishte prushi në sobë. Shkoni e thirrnie Rasimin te pojata, - foli Faria. Shkoi njëri nga djemtë dhe Rasimi erdhi. "Si në të fikun asht soba, - i tha Rasimit. - Shko e çaj pak dru të holla për sobën se këto janë të trasha!" Rasimi nuk bëzajti, por doli si përtueshëm. Këtë e vuri re edhe Faria e, si për të shprehur pakënaqësinë për këtë përtim, lëvizi postiqen ku ishte ulur. Rasimi mori sëpatën dhe i çau drutë. I çoi te soba. Futi tri-katër në sobë dhe ajo u ndez buballan.

Rasimi doli përtueshëm e përtueshëm erdhi me krahun e druve, se kishte kohë që kujtonte punën e tij, por edhe shtëpinë e tij. Pse pak kishte qenë kur i ranë ujqit - një lukuni e ai, de këtu e de atje, luftoi e luftoi të mos i prekej tufa? Dhe iu varrua vetëm një dele në qafë. Po, kur u bë ajo furtuna në Livadh të Gjatë? Binte breshër. Uturinte era si në majë të Korabit. Shkreptinte e bubullinte si të çahej pylli e për çdo bubullimë delet bufllonin sa nga njëra anë tek tjetra. Kështu e kanë delet. Kur tremben, hovin pas njëra-tjetrës si tufë sorrash. Gjysma e deleve u fut thellë në pyll. Këtu mbeti gjysma tjetër. Frika nga ujku këtu; frika nga ujku atje. Vangjet e opingave iu këputën. Këmbët i rrëshqisnin si në akull. Por, tufën e shpëtoi. Po, kur shpëtoi qengjin e llashkës, duke e ngrohur e duke e mëkuar si të ishte fëmijë? Po, kur u dha qenve bukën e vet nga anxhiku se ishin të pangrënë e po bënin rrugë të gjatë dimri? Po, kur...? Po, kur...? Të gjitha ndodhitë kishin një emër: merakun e ndezullinë për punë. Kishte kohë Rasimi që kujtonte e numëronte me vete. Kishte kohë që pati menduar dhe ta thoshte një fjalë. A ishte ky çasti? Ndoshta. Dhe tha: "Unë nuk do të çaj ma dru këtu. Do të çaj për shpinë teme. Do të rropatem për shpinë teme. Do të ngarend për shpinë teme. Do të ruej dele për shpinë teme; ani, nji le të kem, do ta shumoj e do ta baj tufë. Shpia juej asht e mirë e edhe unë due ta baj të mirë shpinë teme". Deshte të thoshte se edhe katundi i tij ishte i mirë. Deshte të thoshte, siç e kishte thënë para djemnisë së katundit se vërtet, vallet i kishte të bukura Valana, por të katundit të tij ishin ma të bukura. Ata kishin vallen e brezatarwve, kangët e dhandërisë e do lojna dhome ma të bukura se ajo e shqiponjave. Deshte të thoshte se katundi i tij edhe cucat i kishte ma të bukura. Deshte t'i thoshte këto, por ai ishte djalë i zgjuar. Përpara një burri, përpara një pronari, përpara një ikjeje, s'ishte vendi të thuheshin këto. Ai tha vetëm: "Do të shkoj të çaj dru për shpinë teme. Do të ngarend për shtëpinë teme ...".

kronikë

Klasën e katërt të shkollës pedagogjike në Katund të Ri në Tiranë sivjet nuk e hapi si gjithmonë mësuesi kujdestar Allaman Xharri. Ai nuk ishte këtë vit shkollor. Jeta e tij u këput në mes në këtë fillim shtatori nga një sëmundje e gjatë dhe e pashërueshme…

"Myftinia e Dibrës dhe Rruzhdi Lata"

Një libër me vlera të mëdha edukative

Në këtë libër publicistiko-letrar jepen shkrime studimore për figura të ndritura të Myftinisë së Dibrës, pasqyrohet me korrektësi atdhetarizmi, përkushtimi ndaj fesë si dhe fisnikëria e njerëzve të besimit për të ndritur kombin, për të mbrojtur atdheun e flamurin, për të përhapur dritën e diturisë, arsimimin dhe kulturën.

"Myftinia e Dibrës dhe Rruzhdi Lata" është një libër piblicistiko- studimor ku zbërthehen figura të ndritura të historisë së myftinisë me rëndësi jo vetëm për Dibrën, por edhe për kombin tonë.

Qysh në kapitullin e parë jepet "Drita e myftinisë", shembulli i fisnikërisë së figurave të ndritura, të cilat mbollën paqetim-vëllazërimin, unitetin fetar e vëllazëror, luftën për liri, pavarsi e dituri, përpjekjet dhe lufta për çështjen kombëtare. Autori krahas dhënjes në mënyrë sintetike të



veprimtarisë e të portretizimit të figurave ka dhënë në mënyrë mjeshtërore e realiste vargjet ku përjetohet atdhetarizmi i mjaft figurave të shquara të myftinisë së Dibrës si Said Najdeni(Hoxhë Voka), Haxhi Vehbi Dibra, Sherif Langu, Sali Ferhati, Sheh Sula, Haziz Lila, Fejzë Bulqiza, Hoxhë Buci, Hoxhë Kuta, Hoxhë Muglica, Hoxhë Bodini, Hoxhallarët e Blliçes e të Rekës, kapitulli për magjistër Rruzhdi Latën, shkrim e baladë për Hafiz Ali Korçën etj. Në këtë libër jepen plot mesazhe për mirësinë, për virtytet e larta të popullit tonë, veçanërisht paqëtim-vëllazërimin. Autori Mevlud Buci shkruan me realizëm, frymëzim e qartësi. Ngjarjet e figurat i gdhend nëpërmjet shkrimeve e poezive mjeshtërore ku mbi të gjitha jepet atdhetarizmi i myftinisë e përkushtimi për pavarsi e dituri. Libri "Myftinia e Dibrës dhe Rruzhdi Lata" është një libër me vlera të mëdha edukative, me vlera historike e letrare ku shpërfaqet drita e fisnikërisë.

Çelik Petriti

PORTRET

Një emër i njohur në fushën e mësimdhënjes

E shikoj çdo ditë në mëngjez kur del shpejt nga shtëpia e merr gazetën. Megjithëse mbi supe i rëndojnë afro 85 vite ende është fortë. Asnjëherë nuk përdor shkopin që të ndihmojë këmbët. I lindur dhe rritur në Lurën e bukur, me një klimë tepër shëndetsore, mësuesi pensionist Ali Koçeku nuk e ndjen peshën e viteve që i rëndojnë mbi supe. Energjik si gjithmonë Aliun nuk e gjen asnjëherë nëpër parqe ku mblidhen pensionistët duke lozur domino. Ai në mëngjez ka pasion gazetën dhe një kafe me e shokët që i ka të shumtë. Ali Koçeku ka mbaruar Universitetin e Tiranës për gjuhë – letërsi. Ka punuar me devotshmëri e pasion për vite të tëra si mësues duke filluar qysh në shkollën e Kastriotit, drejtor shkolle në Lurë . Nga 1959 deri 1966 ka punuar inspektor në seksionin e arsimit në Peshkopi. Në 1966 largohet nga qyteti i Peshkopisë dhe vendoset me shtëpi në Krujë ku dhe këtu filloj punë në arsim si drejtor shkolle në Mamurras e Gjorm. Aliu krahas punës si mësues ka qenë një ndër bashkëpuntorët më të shquar të gazetës "Ushtima e Maleve". E sot pas viteve kur mbushi moshën e pensionit pasioni i tij ishte disi ndryshe. Është marrë kryesisht me studime historike me vlerë jo vetëm për vendlindjen e tij Lurën por dhe më gjërë. Ka botuar monografitë "Lura", "Arni", Reçi" e "Çidhna". Edhe në këtë moshë Ali Koçeku i tillë është energjik si dikur, kërkues ndaj vetes dhe të tjerëve.

Nuredi Lushaj

POEZI NGA MYNYR HOXHA



Horoskopi i pastrueses

Kafen e mëngjezit pi i qetë
Nën lejtmotivin e ekspresit
Ndez një duhan mbi një gazetë
E kthej urimet e mëngjezit.

Një mërmërimë pastruesja thotë
Gazetën do ta shoh pak
Dhe i hedh sytë mbi horoskop
E lumtur thërret: sot paskam fat!

Ylli i pastrueses pasurues
E bën të gjorën të kërcej
Një horoskop idiot, mashtrues
Ja solli fatin që ta gjej.

I solli ylli pasuri
Dhe fshesën vërvit atje
Tani lokale më s'do fshij
Si zonjë do vij të pi kafe.

E tek kafenë sapo mbaroj
Palos gazetën me inat
Tek shoh që njerëzit pasuroj
Me një gaforre a bricjap.

Dhe tek pastruesja ëndërron
Të ketë para e shërbëtor
Zëri i pronarit e rizgjon:"
Ç'më rri ashtu me shkop në dorë"

Trembet pastruesja, hidhet hop
Vëngër më shikon zemër thyer
Sikur të isha horoskop
Që poshtërisht kisha gënjyer.

O jetë e thatë, pa gjethe, shkop
Që horoskopin bëre ves
Po t'ishte jeta horoskop
s'do ekzistonte fjala stres.

HOMAZH

Humbëm një njeri të mirë

Shtatori erdhi përsëri e viti i ri shkollor sapo ka nisur. Takohen bashkë mësues e nxënës e biseda nis lirshëm për periudhën e shkurtër të pushimeve. Në shkollën e mesme pedagogjike Katund i Ri nxënësit kanë ardhur të gjithë. Askush nuk mungon, të gjithë janë të pranishëm ditën e parë të shkollës. Por… mungon në fakt një. Klasën e katërt të shkollës pedagogjike Katund i Ri në Tiranë sivjet nuk e hapi si gjithmonë mësuesi kujdestar Allaman Xharri. Ai nuk ishte këtë vit shkollor mes nxënësve dhe mësuesve. Jeta e tij u këput në mes në këtë fillim shtatori nga një sëmundje e gjatë dhe e pashërueshme. Mungesën e tij e ndjejnë nxënësit e vitit të katërt të cilët e kishin mësues kujdestar që nga viti i parë.

Vdekja e parakohshme e mësuesit të talentuar Allaman Xharri ishte një humbje jo vetëm për familjen, për nxënësit e tij, për kolektivin e mësuesve ku punoi për vite me radhë por dhe për të gjithë ne shoqërinë. Një djalë i heshtur, një intelektual i kompletuar, një mësues i shkëlqyer, një kuadër me përvojë në fushën e mësimdhënjes. Ashtu siç ishte i heshtur, ashtu dhe në heshtje u largua përgjithmonë nga gjiri ynë. Do ta kemi përherë para syve imazhin e mirë të tij tek dilte çdo mëngjez nga shtëpia për në punë dhe kthehej pas dite. Me çantën në dorë, me buzën në gaz, me përshëndetjen e tij karakteristike vetëm me një tundje koke. Shpesh herë ndodh që, duke udhëtuar në vazhdimësinë e jetës, njerëzit të skicojnë e të ndërtojnë, të parashikojnë e të ndeshen me sfida e punë që kërkojnë domosdo dhe sakrifica të mëdha e përkushtim. Kështu ndodhi dhe me mësuesin e talentuar Allaman Xharri. Ai donte ta jetonte jetën, tentonte të kishte rezultate më të larta, por ajo iu këput në mes, në moshën më të bukur, i ngriu në mendje gjithçka që kishte projektuar. U largua nga jeta në një kohë që sapo e kishte filluar atë, që nuk ishte ngopur ende mirë me të, pa u çmallur me babën, motrën, vëllezërit, miqtë e shokët, nxënës e koleg.

Allamani lindi në fshatin Brezhdan më 20 tetor 1968 ku vetëm pak dit e ndanin nga përvjetori i madh i ditëlindjes që ndoshta do ta festonte mes nxënësish dhe kolegësh herën e parë dhe pastaj edhe në familje që e deshën dhe i deshi gjithmonë deri minutat e fundit të jetës së tij. Nga familja ku u lind dhe u rrit mori një kulturë dhe edukatë që e karakterizoi gjatë gjithë jetës së tij të shkurtër. U arsimua në Universitetin e Tiranës në degën biologji-kimi për mësues ku me dashuri e pasion iu përkushtua profesionit të mësuesit. Më vonë bëri dhe një specializim për shkollat e mesme. Ishte i dashur dhe respektuar me nxënës dhe mësues. Allamani ka punuar në vende të ndryshme si në Brezhdan, Fushë-Alie, Kastriot, Peshkopi e së fundi dhe në shkollën pedagogjike Katund i Ri në Tiranë. Në Peshkopi ka punuar edhe si inspektor arsimi në Drejtorinë e Arsimit të Rrethit. Të gjithë e njohën mësuesin model e shembullor, komunikues me nxënësit e kolegët, komunitetin ku jetonte prej vitesh që e respektonin të gjithë. E këtë respekt Allamani ua kishte imponuar të gjithve me sjelljet shembullore, me sinqeritetin e tij, me moralin e lartë që e karakterizonte kudo e në çdo gjë.

Fjalët më të mira thonë të gjithë, nxënës dhe mësues që kanë patur fat ta kenë mësues dhe koleg Allaman Xharrin. E kjo u pa ditën e varrimit ku nuk mbeti sy i papërlotur tek të gjithë, nxënës dhe mësues.

-Na humbi një mik, shok dhe koleg me përvojë. Do ta ndjejmë gjatë këtë humbje që na ndodhi sot. Kështu do të shprehej me lot në sy, një mësuese që kishte punuar gjatë me Allamanin. Ai kishte fituar një përvojë të pasur në fushën e mësimdhënjes dhe lënda e tij ishte një ndër ato lëndë që edhe pse shkencë ekzakte për nxënësit ishte bërë mjaft e dashur. E këtë nxënësve ua bënte vetë Allamani me spjegimin që i bënte lëndës.

Sot viti i ri shkollor ka nisur. Allamani nuk jeton më. Ai iku në një moshë fare të re ku kishte mundësi me dhënë më shumë në fushën e mësimdhënjes. Ky nderim për mësuesin Allaman Xharri u vu re edhe ditën e fundit të tij kur trupi i pa jetë u përcoll për në banesën e fundme.

Me qindra e qindra qytetarë, ish nxënës e nxënës, koleg e prindër dolën në shenjë nderimi dhe mirënjohje. Me lot në sy e zemër të thyer, u ndanë këtë ditë shtatori duke i dhënë lamtumirën e fundit mësuesit që do të mbetet gjithmonë shembull për shumë mësues të tjerë.

Sh. Skarra

reklamë

Festa e të vjelave organizohet nën kujdesin e Departamentit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorwve dhe pushteteve Lokale, Qarku Dibër.
Mbështetur nga SNV

Drejtoria Rajonale e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit Dibër, në bashkëpunim me Qarkun, komunat, bashkitë dhe SNV/Dibër organizon Festën e të Vjelave.
Ajo fton të marrin pjesë në këtë aktivitet donatorë, organizata zhvillimi, institucione, projekte, tregtarë dhe industrialist, specialist të fushës së bujqësisë.

3-4 TETOR 2008
BULEVARDI KRYESOR
NË PESHKOPI

Kontaktoni:
Drejtoria Rajonale e Bujqësisë Dibër, lagja "Dobrovë",
Tel. +21822173, +21825602
Email:
dr.bujqesisediber@yahoo.com



KALENDARI "DIBRA 2009"

Me rastin e botimit të edicionit të ri të kalendarit "Dibra 2009", ftojmë fotografë profesionistë dhe amatorë, si dhe subjekte private e organizata, të bëhen pjesë e kalendarit, me foto apo me logon e aktivitetit të tyre.

Aplikimet pranohen deri me datë 30 tetor.

Për më shumë detaje telefononi:
Tel. (04) 22 33 283
Mob: 069 20 68 603.

E-mail: mbbotime@ gmail.com;
djmenny@gmail.com

botime & studio grafike

ju ofron botime cilësore dhe të standardeve bashkëkohore
libra - revista - gazeta - fletëpalosje - postera - broshura -
kartolina - ftesa - kartvizita - shërbim fotografik....

mirë.... bukur.... lirë....

00355 4 22 33 283
069 20 68 603
mbbotime@gmail.com

PAJTOHUNI NË GAZETËN "RRUGA E ARBËRIT"

Pajtimet në Tiranë mund t'i bëni pranë redaksisë së gazetës në numrat:
Cel: 068 31 19 232 ose në numrin fiks (04) 22 33 283.

Pajtimet në Peshkopi mund t'i bëni pranë librarisë "Fleta XXI", pranë Gjimnazit "Said Najdeni", me nr. tel: 0218 4233.

Të interesuarit për abonime duhet të lënë patjetër emrin e saktë dhe adresën ku presin t'ju shkojë gazeta.

- KËRKOHEN KORRESPONDENTË NE RRETHET DIBËR, LEZHË, DURRËS.

- BENI NJOFTIMIN TUAJ TE BIZNESIT

Bëhuni pjesë e gazetës!

Numri i radhës së gazetës do të dalë çdo të diel të fundit të muajit.

Tel. (04) 22 33 283. E-mail: rrugaearberit@gmail.com.
www.**dibra**.org

*Grafika: **Studio "m&b"**. Tel: (04) **2233 283**.*